
BULETINI INFORMATIV

Prill 2025

AKADEMIA E SHKENCAVE
E SHQIPËRISË



**Buletin mujor i aktiviteteve të Akademisë së
Shkencave të Shqipërisë**

Prill, 2025

Përmbajtje

Projekti madhor “Enciklopedia shqiptare”	6
U zhvillua mbledhja e redaksisë qendrore dhe vendore Tiranë për “Enciklopedinë shqiptare”	7
U zhvilluan takimet mes drejtuesve të redaksive të fushave dhe anëtarëve të redaksisë vendore-koordinatorë të grupfushave	9
Projekti madhor “Historia e shqiptarëve”	12
Takimi i redaksisë qendrore, Tiranë, të projektit madhor “Historia e shqiptarëve”	13
Panairi mbarëkombëtar i librit akademik e shkencor, edicioni i IV	15
Panairi mbarëkombëtar i librit akademik e shkencor, 23-25 prill 2025, Prishtinë	16
Akademike Myzaferre Limani u shpall fituese e çmimit për veprën më të mirë studimore në edicionin IV të Panairit të librit akademik	19
Panairi mbarëkombëtar i librit akademik e shkencor mbylli edicionin e tij të katërt në Prishtinë.....	21
Takime pune	26
Takimi i Kryetarit të Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi me Rektorin e Universitetit Sllav të Bakusë, Azerbajxhan, prof. Anar Naghiyev.....	27
Aktivitete	30
Prof. dr. Dhori Qirjazi mbajti dy ligjërata: “Të dhëna të reja për Fjalorin [italisht-]greqisht-shqip të Marko Boçarit" dhe "Për një botim të ri të 'Alipashiadës' së Haxhi Sheretit"	31
U mbajt ligjërata me temën “Veçori tipologjike të sintaksës shqipe: rasti i nyjave të përparme" nga prof. asoc. Aristotel Spiro	34
Departamenti i Studimeve Letrare, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, zhvilloi konferencën shkencore me tematikë letërsinë biografike dhe autobiografike shqipe	36
Qendra e Studimit të Arteve zhvilloi sot një veprimtari për 95-vjetorin e lindjes së inxhinierit dhe historianit të kinemasë Abaz Hoxha	41

Qendra e Studimit të Arteve zhvilloi veprimtarinë me temën “Dëshmi për brezat që do të vijnë, krijimi i arkivit të emigracionit shqiptar në Greqi”	44
U mbajt leksioni i hapur me temën “Vdekja e (pa)shpjegueshme e teatrit radiofonik shqiptar”	46
Qendra për Koordinimin dhe Përhapjen e Informacionit Shkencor pranë ASHSH-së nisi ciklin e parë të trajnimeve për specialistët e rrjetit të bibliotekave të Shqipërisë të përfshira në sistemin COBISS.....	49
U zhvillua në qytetin e Ulqinit konferenca shkencore “Ana e Malit nga lashtësia deri sot” në 20-vjetorin e shoqatës “ORA”	51
Akademike Aurela Anastasi prezantoi temën: “Çështje të metodave të kërkimit shkencor përmes “dialogut gjyqësor kushtetues””	53
U zhvillua workshop-i me temën “Korniza referuese gjeodezike dhe modelimi i gjeoidit në Republikën e Shqipërisë”	55
U zhvillua tryeza e rrumbullakët me temën “Kriobanka bimore "Akademia": e para në Shqipëri, rezultate dhe perspektiva”	59
U zhvillua simpoziumi me temën “Trashëgimia e ADN-së: Nga zbulimi në inovacionet e ardhshme”	61
Prof. asoc. Selami Xhepa prezantoi një ligjëratë me temën “Sistemet e inovacionit: një vështrim krahasues”	65
Komisioni i Mjekësisë, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, zhvilloi tryezën e rrumbullakët “Autizmi në Shqipëri”	67
Njësia e përkohshme e kërkimeve gjeografike zhvilloi veprimtarinë e parë shkencore	70
Jubile akademik	74
Akademia e Shkencave dhe kryesia e saj i urojnë akademikes Aurela Anastasi: Gëzuar 60-vjetorin e lindjes!	75
In memoriam.....	77
“Fizika në shekullin XXI”, veprimtari përkujtimore për fizikanin e shquar akademik Artan Boriçi	78
Ndahet nga jeta aktorja e mirënjohur shqiptare Margarita Xhepa	82
Letër ngushëllimi	84

UNESCO dhe Shqipëria	86
“Muzeu Kombëtar i Fotografisë “Marubi” u shpall pjesë e regjistrit të kujtesës botërore UNESCO.....	87

Projekti madhor “Enciklopedia shqiptare”

U zhvillua mbledhja e redaksisë qendrore dhe vendore Tiranë për “Enciklopedinë shqiptare”

Sot më 2 prill 2025 u zhvillua mbledhja me anëtarët e redaksisë qendrore dhe vendore Tiranë për projektin madhor “Enciklopedia shqiptare” me drejtimin e kryeredaktorit të veprës akad. Skënder Gjinushi, kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.



Morën pjesë akad. Anila Hoda, sekretare shkencore e ASHSH-së; akad. Shaban Sinani, drejtues i redaksisë vendore dhe përgjegjës i seksionit për “Enciklopedinë shqiptare”; dr. Arian Leka, drejtori i Qendrës së Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike; akad. Dhimitër Haxhimihali; akad. Ilirian Malollari; akad. Kosta Barjaba; prof.dr. Perikli Qiriazhi; akad. Adem Bunguri; prof. dr. Aleksandër Xhuvani; prof. dr. Aljula Jubani dhe prof. dr. Valbona Toska (online) nga Maqedonia e Veriut.

Mbledhja u zhvillua për t’u njohur me konkluzionet e takimit dyditor të redaksive vendore Shqipëri- Kosovë, mbajtur në Vërmicë më 25-26 mars 2025, për ecurinë e mëtejshme deri në shqyrtimin e miratimit të fjalësit të projektit “Enciklopedia shqiptare” prej redaksisë qendrore pas miratimit të tij prej dy redaksive vendore.

Akad. Gjinushi tha se në Vërmicë u përcaktuan e formuluan disa detyra e rekomandime për redaksitë e fushave në përgatitje të fjalësit të unifikuar për t’ia përcjellë redaksisë qendrore, të cilat do të përmbliidhen në një udhëzues. Ndërkohë QBEA-ja në bashkëpunim me drejtuesit e redaksive të fushave, të cilat do të shërbejnë si materiali bazë mbi të cilat do të reflektohen rekomandimet e kërkesat e shtruara në

Vërmicë e në këtë takim.



Në takim u bë dhe një ndarje detyrash për çdo anëtarë për këtë fazë.

Drejtori i QBEA-së, dr. Arian Leka shprehu dakordësinë me udhëzimet e dhëna nga redaksia qendrore veçanërisht në drejtim të garantimit e verifikimit të plotësimit të kriterëve për çdo artikull, detyruar kjo dhe nga fakti se 70 për qind e “Enciklopedisë shqiptare” është lëndë e re. Organizimi i punës do të synojë që fjalësi të miratohet nga redaksia qendrore deri më 15 maj për të kaluar në fazën e kategorizimit të artikujve dhe përcaktimin e autorëve hartues të tyre.

www.akad.gov.al

U zhvilluan takimet mes drejtuesve të redaksive të fushave dhe anëtarëve të redaksisë vendore-koordinatorë të grupfushave

-Takimet u zhvilluan për shqyrtimin e Udhëzuesit për ecurinë e mëtejshme në përgatitjen e fjalësit të “Enciklopedisë shqiptare” dhe njohjen e miratimit të kalendarit të punës në vijim-



Në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, në datën 17 prill 2025, u zhvilluan takimet me 27 redaksi të fushave dhe anëtarëve të redaksisë vendore Tiranë, gjithashtu koordinatorë të grupfushave. Ata u njohën me Udhëzuesin e përbashkët të miratuar për fazën e re të punës me përgatitjen e fjalësit të “Enciklopedisë shqiptare” para dorëzimit për miratim redaksisë qendrore.

Këto veprimtari u zhvilluan në vijim të takimit të dy redaksive vendore Tiranë e Prishtinë më 25-26 mars 2025 në Vërmicë, ku u miratua fjalësi-bazë dorëzuar i dakordësuar nga redaksitë e fushave deri më 20 shkurt 2025, pranë QBEA-së.

Takimet e ndara në 7 grupe pune sipas grupfushave u drejtuan nga kryeredaktori i “Enciklopedisë shqiptare” akad. Skënder Gjinushi, Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, dhe dr. Arian Leka drejtor i Qendrës së Botimeve Enciklopedike Shqiptare.

Fillimisht kryeredaktori i Enciklopedisë shqiptare akad. Skënder Gjinushi dhe zëvendëskryeredaktori akad. Mehmet Kraja nënshkruan udhëzuesin për redaksitë e

fushave për përgatitjen e fjalësit enciklopedik (ESH) para dorëzimit për miratim në redaksitë qendrore.

Në vijim të punës u diskutua rreth udhëzuesit të ri dhe u dhanë detyra e rekomandime duke theksuar çështje në vëmendje.



Akad. Gjinushi theksoi forcimin e artikujve me argumente shtesë, përkrah kriterit bazë dhe tha se propozime për ndryshime, si rregull, do të ketë vetëm për raste që kriteri nuk i parashikon apo kur vijnë në mbështetje të karakterit përmirësues, të përmendura në udhëzuesin e ri. U theksua, gjithashtu, nevoja për kalime të mëtejshme në artikujt përmbledhës, evitimi i ndarjeve të panevojshme gjeografike apo tematike a kohore, riadresime drejt njësisë së dominancës, si dhe qartësimi i emërtimeve në formën e shkrimit të tyre përmes fjalës çelës. Për çdo ndryshim dhe shtesë, a heqje nga fjalësi bazë, shprehet mendimi nga drejtuesit e redaksive të fushave.

Redaktorët përgjegjës dhe drejtuesit e redaksive të fushave ranë dakord me detyrat e përcaktuara dhe rekomandimet e bëra për përmirësimet në udhëzuesin e ri:

U la detyrë për personalitetet, të përfshira në fjalës si artikuj më vete për shkak të kontributit të tyre si studiues, krijues, kërkues, mësimdhënës, zbatues e politikanë, të vihet përbri argumenti kryesor e kontributi i veçantë pse vlerësohet se i plotëson kriteret e parashikuara, si p.sh. për mbajtësit e titullit profesor, të shpjegohet edhe kontributi i veçantë në veprimtarinë e tyre, që i dallojnë nga profesori. Për personalitetet historike ky shpjegim bëhet kur shihet i nevojshëm.

U la detyrë që për ngjarje të veçanta historike, më pak të njohura, gjithashtu, të jepet argumenti kryesor pse ngjarja përkatëse duhet të jetë artikull më vete.

Për fjalësin bazë për çdo propozim të bërë pas datës 20 shkurt 2025 e të paraqitur në Vërmicë bashkë me dakordësinë të shprehet edhe arsyeja e propozimit të fjalës. Fjalësi të shoqërohet me kategorizimin e madhësisë së artikujve, me propozimet për artikujt monografikë dhe artikuj përmbledhës të karakterit monografik, që sipas vlerësimit të redaksive të fushave çmohen se duhen trajtuar posaçërisht.



Në përfundim, u miratua kalendari i përbashkët i aktiviteteve për periudhën prill-qershor 2025 që do të realizojnë të dyja institucionet Akademia e Shkencave Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, me qëllim përmbushjen e detyrave për realizmin e përbashkët të veprës madhore “Enciklopedia shqiptare”.

Për përmbushjen e detyrave u përcaktuan katër afate kohore, sipas programit të miratuar.

www.akad.gov.al

Projekti madhor “Historia e shqiptarëve”

Takimi i redaksisë qendrore, Tiranë, të projektit madhor “Historia e shqiptarëve”



Sot në datën 10 prill 2025 në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u mbledh redaksia qendrore, Tiranë, e projektit madhor “Historia e shqiptarëve”, e përbërë nga akad. Pëllumb Xhufi, prof. dr. Paskal Milo, prof. dr. Ferit Duka, prof. dr. Neritan Ceka.

Takimi u zhvillua me praninë e zëvendëskryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Vasil Tole.

Ky takim ka si qëllim diskutimin në redaksitë qendrore të punimeve që janë përgatitur për vëllimin e dytë të “Historisë së shqiptarëve”, që përfshin periudhën nga shekulli XI e deri në përfundim të epopesë së Skënderbeut që është pushtimi i Shkodrës në vitin 1478. Si parathënie e këtij takimi është saktësimi i të gjithë periudhës së antikitetit të vonë dhe të mesjetës së hershme, kur formohet kombësia arbërore dhe vërtetimi tezës së trashëgimisë iliro- arbërore, duke ndërthurur studimet e burimeve arkivore me të dhënat arkeologjike.

Në diskutim u vlerësua përmbajtja e katër kapitujve të parë, të cilët kanë të bëjnë me periudhën e shekullit XI e XIV para Skënderbeut. Kjo është periudha e mesjetës feudale shqiptare, ku ndodhin procese të rëndësishme, ku nis feudalizmi perëndimor i shqiptarëve të Arbërisë, lindja e principatave të para autonome feudale shqiptare, Topiaj, Muzakaj, Shpataj e Balshajt, që formojnë pastaj edhe preludin për fillimin e epokës së Skënderbeut.

U diskutuan çështjet kryesore për përmirësime të mëtejshme të tekstit të

“Historisë së shqiptarëve” dhe u vlerësuan kapitujt e punimit të akad. Pëllumb Xhufit si për mënyrën e re të parashtrimit të historisë, jo vetëm si histori politike, por edhe si histori e qytetërimit arbëror të kësaj periudhe.



Puna me hartimin e historisë do të qëndrojë në këtë metodologji dhe do të vijojë me diskutimin kapitull pas kapitulli në mënyrë që jo vetëm të korrigjohen aspektet që kanë të bëjnë me çështjet teknike, po kryesisht të përforcohen momentet që duhet të profilizojnë një histori me të vërtetë të shkruar ndryshe për shqiptarët.

www.akad.gov.al

Panairi mbarëkombëtar i librit akademik e shkencor, edicioni i IV

Panairi mbarëkombëtar i librit akademik e shkencor, 23-25 prill 2025, Prishtinë



Sot, më 23 prill 2025, në Prishtinë, Panairi mbarëkombëtar i librit akademik e shkencor nisi edicionin e tij të katërt.

Të pranishëm në sesionin e hapjes ishin akad. Skënder Gjinushi, Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë; akad. Mehmet Kraja, Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës; anëtarë të Kryesisë së ASHSH-së dhe ASHAK-ut; rektorë e drejtues; përfaqësues të universiteteve dhe institucioneve të tjera të arsimit të lartë e të kërkimit shkencor në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni të Veriut, Mal të Zi; si dhe botues të librit shkencor, kërkues, studiues, autorë dhe lexues të interesuar.

Kryetari i ASHAK-ut, akademik Mehmet Kraja hapi veprimtarinë me një fjalë përshëndetëse për të pranishmit, ku theksoi domosdoshmërinë për vëmendjen, mbështetjen dhe përkujdesjen e veçantë shtetërore dhe institucionale që kërkon libri shkencor. Ai tha se në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, që nga themelimi i saj, këtu e 50 vjet të shkuara, botimet janë konsideruar parësore në punën e saj dhe përbëjnë njërën nga shtyllat kryesore të programit vjetor të punës. Ne konsiderojmë se kemi arritur një nivel të mirë të këtyre botimeve, porse kemi akoma punë për të bërë, për ta hapur veprimtarinë botuese ndaj autorëve jashtë Akademisë, jo sipas rastit, por sipas një koordinimi dhe të një vlerësimi publik.

Tani, ky Panair, që sivjet mbahet në Prishtinë, vitin tjetër në Tiranë, kështu

gjithnjë, do të bëhet i rëndësishëm nëse arrin të tërheqë vëmendjen e opinionit, nëse jo të opinionit të gjerë, së paku të botës akademike, duke nxjerrë në pah vlera të qëndrueshme shkencore dhe duke promovuar autorë dhe arritje gjithnjë e më të mëdha dhe më domethënëse.

Në fund të fjalës së tij, akad. Kraja i uroi pjesëmarrësit për një zhvillim të suksesshëm të Panairit IV të librit shqip, shkencor dhe akademik, dhe falënderoi Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit si bashkëorganizatore për kontributin e tyre, për këtë eveniment të shkëlqyer.



Me këtë rast, Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi mbajti një fjalë përshëndetëse. Ai foli për traditën e krijuar me Panairin mbarëkombëtar të librit akademik e shkencor që përkon me një ditë të rëndësishme për autorët e botuesit, Ditën Botërore të Librit dhe të së Drejtës së Autorit.

Akad. Gjinushi theksoi se Panairi i librit akademik e shkencor është shprehje e vullnetit të qartë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, të cilat bashkëpunojnë ngushtësisht në të gjitha fushat, veçanërisht në albanologji. Fryt i këtij bashkëpunimi dypalësh është edhe puna për projektet e mëdha, si ai i “Enciklopedisë shqiptare” dhe “Historisë së shqiptarëve”. Ky panair është vendi i duhur për promovimet e atyre botimeve, të cilat na bashkojnë në origjinën tonë të përbashkët dhe njëherësh në sfidat drejt integritimit në Bashkimin European. Si rrallë organizim tjetër, ky panair i jep vëmendjen e merituar figurës së

kërkuesit shkencor.

Ai theksoi më tej se panairi synon që botimet akademike e shkencore ta gjejnë lehtësisht rrugën drejt lexuesit, para së gjithash atje ku kërkimi është institucional, në bibliotekat shkencore, universitare, por edhe publike, të institucioneve arsimore e kulturore, brenda e përtej kufijve. Në përmbushje të këtij misioni, Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhuron botimet e veta për pasurimin e fondeve të këtyre bibliotekave, në mënyrë që libri akademik të jetë sa më pranë lexuesit të vet.

Së shpejti, Akademia e Shkencave e Shqipërisë do të ketë entin e saj botues, nëpërmjet të cilit do të botojë si periodikët, ashtu edhe veprat e studimet e kryera (mbi 65 tituj), përfshirë edhe ato nga personeli akademik jashtë institucionit, çfarë do të ndihmojë në rritjen e rolit tonë promovues e divulgues për të rejtat në çdo lëmi të shkencës, për veprimtaritë dhe figurat tona kryesore.

Në fund të fjalës së tij akad. Gjinushi tha se ky panair është një rast i shkëlqyer për të krijuar marrëdhënien e mezipritur midis botuesve e lexuesve, dhe kjo shkon në përputhje me strategjinë tonë të hapjes së përgjithshme ndaj sistemit të kërkimit shkencor dhe ndaj të gjithë faktorëve që janë të interesuar për t'u bërë pjesë e tij, duke shmangur ishullizimin, izolimin, e duke rritur bashkëpunimin dhe konkurrencën.

Panairi do të qëndrojë i hapur deri në datën 25 prill 2025, ora 11:00.

www.akad.gov.al

Akademike Myzafere Limani u shpall fituese e çmimit për veprën më të mirë studimore në edicionin IV të Panairit të librit akademik



Në ditën e dytë të edicionit IV të Panairit mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor, që po zhvillohet në Prishtinë, u shpall çmimi për veprën studimore më të mirë.

Ceremoninë e hapi Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, akad. Mehmet Kraja, i cili ia dha fjalën drejtoreshës së Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit znj. Alda Bardhyli për shpalljen e çmimit. Ajo çmoi bashkëpunimin mes dy akademive në këtë nismë të përbashkët për organizimin e panairit dhe u shpreh se Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit e mbështet çmimin për “Veprën më të mirë studimore” që propozohet nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës.

Çmimi për “Veprën më të mirë studimore” iu akordua akademike Myzafere Limanit për veprën “Akustika, të folurit dhe muzika”.

Znj. Bardhyli i bëri ftesë kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushit për dorëzimin e çmimit. Ai lexoi motivacionin e çmimit, ku theksohej se: “Me një aparat matematikor relativisht të thjeshtësuar, libri paraqet burim të pasur

dhe të besueshëm të informacioneve edhe për studiuesit dhe ekspertët e fushave të tjera që ndërlidhen me akustikën, sinjalet e të folurit dhe muzikën”.



Në fjalën e saj, fituesja e çmimit akad. Limani falënderoi dy akademitë për vlerësimin që iu bë. "Libri shkencor ka një numër të kufizuar lexuesish dhe zakonisht qëndron i fshehur. Edhe ky libër do të gjejë interesim te muzikantët dhe inxhinierët e fushës, ndaj e quaj të lartë vlerësimin që është bërë për librin, për punën dhe ju falënderoj të gjithëve".

www.akad.gov.al

Panairi mbarëkombëtar i librit akademik e shkencor mbylli edicionin e tij të katërt në Prishtinë

U mbyll edicioni IV i Panairit mbarëkombëtar të librit akademik e shkencor, 23-25 prill 2025, zhvilluar në Prishtinë. Ngjarja më e rëndësishme për promovimin e botimeve shkencore, bashkorganizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Qendra e Kombëtare e Librit dhe Leximit, mbledhi bashkë në Prishtinë, në ambientet e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, botues të librit shkencor, kërkues, studiues, autorë dhe lexues nga hapësira mbarëshqiptare.

Më 23 prill 2025, në ditën e parë të panairit, në një seancë të dedikuar, me praninë e Kryetarit të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, akad. Mehmet Kraja, kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi, zëvendëskryetarit të ASHSh-së, akad. Vasil S. Tole, anëtarëve të Kryesisë, akademikë e studiues të ASHAK-ut, autorë, botues e pjesëmarrës të interesuar për botimet shkencore, Akademia e Shkencave e Shqipërisë promovoi botimet e saj më të fundit.



Seancën e hapi kryetari i Seksionit të Shkencave Shoqërore e Albanologjike, akad. asoc. Gëzim Hoxha. Duke falënderuar dy akademitë për organizimin e panairit, kthyer tashmë në traditë, akad. asoc. Hoxha theksoi para të pranishmëve se titujt e zgjedhur

për promovim në këtë edicion të panairit janë vetëm një pjesë e vogël e volumit të madh të punës me librin dhe botimet shkencore të ASHSH-së përgjatë vitit dhe se në këto promovime ASHSH-ja është kujdesur për të ruajtur edhe një balancë mes fushave të shkencës.



Libri i parë që u promovua ishte "Akte të Kuvendit Ndërkombëtar të Studimeve Albanologjike" (vëll. 3), për të cilin referoi kryetari i SSHSHA, akad. asoc. Hoxha, duke u ndalur hollësisht në lëndën shkencore të përfshirë në këtë vëllim. "Në këtë vëllim përfshihen 20 kontribute me vlerë nga historia, historia e artit, trashëgimia, historia e letërsisë dhe letërsia, të cilat pasojnë dy vëllimet e mëparshme, Vëllimin I të dedikuar për arkeologjinë e historinë me 26 kontribute dhe Vëllimin II për gjuhësinë dhe antropologjinë me 42 kontribute të emrave më përfaqësues të fushave", tha ai, duke shtuar se vëllimet janë dokumentim i një pune voluminoze dhe të rëndësishme të bërë në kuadër të Kuvendit Ndërkombëtar të Studimeve Albanologjike.

"Orkestra Simfonike e RTSH-së në 18 CD" dhe "Albanian Identity in History and Traditional Performance" ishin promovimet pasuese, të kryera në prani të autorit të tyre, maestro Eno Koços. Zëvendëskryetari i ASHSH-së, akad. Vasil S. Tole, duke folur për 18 CD-të, theksoi se puna e maestros, dirigjent e muzikolog, anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë përmban veprat e kompozitorëve më të rëndësishëm të muzikës shqiptare të shek. XX, nga fillimet e deri në ditët e sotme, vepra të drejtuara nga dirigjenti Eno Koço me orkestrën simfonike të RTSH-së përgjatë 50

viteve të fundit. Ai e çmoi kolanën si një kontribut unik të maestro Koços, që çdo herë përmes krijimtarisë së tij shpreh dashurinë për muzikën tonë kombëtare, mbarëkombëtare, si dhe u ndal në CD-në e dedikuar me muzikën e krijuesve më të mirë të Kosovës, që nuk mund të mos ishin pjesë e kësaj kolane me CD. Dr. Denis Bizhga, gjatë referimit të tij u ndal në jetën dhe veprimtarinë krijuese të maestro Eno Koços, duke shprehur falënderim dhe mirënjohje për punën kolosale që profesori ka bërë dhe vazhdon të bëjë.



Referimin e prof. dr. Artan Haxhi (në mungesë të tij) për librin e autorit Tefë Topalli "Krestomaci e albanologjisë" (vëll.1), e lexoi akad. asoc. Gëzim Hoxha. Ai theksoi se struktura e veprës i vendos gjuhëtarët sipas kronologjisë së veprimit të tyre shkencor, nisur prej Kristoforidhit, dhe përmban kontributin e shumë studiuesve dhe kërkimtarëve për lëvrimin e shqipes, shtrirë në 1668 faqe, nga hapësira shqipfolëse, nisur prej Çamërisë, arbëreshëve, Italisë, Kosovës, shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut, si dhe brezave që kanë jetuar e jetojnë brenda Shqipërisë. Në fjalën e tij ai nënvizoi se autori arrin të pohojë se drejtimet studimore të këtyre gjuhëtarëve kanë punuar dhe punojnë në vijë të njëjtë për historinë e gjuhës sonë, për marrëdhëniet e saj me gjuhët e tjera ballkanike apo për problemet që lindin me epokën e globalizmit dhe se kjo Krestomaci mund të krijojë një traditë periodike botimi, së paku me dhjetëvjeçarë.

Abaz Hado referoi për librin e tij më të fundit, "Veshjet tradicionale në artin pamor shqiptar", botim i ASHSH-së, vepër që pasuron me informacionin e nevojshëm

njohjen, ndikimin, bashkëpunimin dhe pasurimin e artit pamor me bukurinë, larminë dhe pasurinë e veshjes tradicionale. Hado, duke folur për punën e gjatë kërkimore të bërë për realizmin e veprës, theksoi se ajo përmbledh në mënyrë selektive, krijimtarinë kryesore të artit shqiptar, prej mbi 100 vjetësh dhe sjell kontribut real, mbi ndikimin, lidhjen, shfrytëzimin e etnografisë, folklorit mitologjik në pikturën, skulpturën, grafikën, vizatimin shqiptar.

Akad. Rrapo Ormëni, bashkautor i veprës "The earthquake of 26 November 2019 and what can we learn" prezantoi përmbledhtas punën e bërë në bashkëpunim me autorin turk Serkan Öztürk për realizimin e kësaj vepre. Vepra sjell analizë të thelluar dhe gjithëpërfshirëse të një ngjarjeje tërmetore, ku trajtohen në mënyrë shkencore aspekte të rëndësishme, si përhapja e valëve sizmike, ndërjegjësimi për rreziqet, për procedurat e evakuimit, si dhe për masat që duhen marrë nga strukturat përkatëse për pasojat. Vepra ka rëndësi jo vetëm për produktin shkencor dhe mesazhet që përcjell, por për të gjithë komunitetin, veçanërisht për vendimmarrësit kryesorë të ekzekutivit për të përgatitur strategji më të mira për të ardhmen.



Prof. asoc. dr. Marenglen Kasmi prezantoi botim e tij "Marrëdhëniet shqiptaro-gjermane në shekullin XX (1900-1945)", i cili trajton hollësisht dhe me dokumente

shumë të pasura arkivore marrëdhëniet shqiptaro-gjermane prej fundit të shekullit XIX e deri në fillimin e Luftës së Dytë Botërore. Vepra pasqyron marrëdhëniet 50-vjeçare mes dy vendeve, të ndara në 3 periudha të historisë, shoqëruar me burime arkivore të panjohura dhe literaturë vendëse e të huaj, kryesisht gjermane, duke hedhur dritë e duke dhënë ndihmesë në trajtimin e një aspekti me shumë interes për historiografinë kombëtare shqiptare.



www.akad.gov.al

Takime pune

Takimi i Kryetarit të Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi me Rektorin e Universitetit Sllav të Bakusë, Azerbajxhan, prof. Anar Naghiyev



Më 7 prill 2025, Kryetari i Akademisë së Shkencave, akad. Skënder Gjinushi priti në një takim prof. Anar Naghiyev, rektorin e Universitetit Sllav të Bakusë, Azerbajxhan.

Rektori shoqërohej nga shkëlqesia e tij ambasadori i Republikës së Azerbajxhanit në Republikën e Shqipërisë, z. Anar Huseynov, si dhe anëtarët e delegacionit, si prof. Nurlana Mustafayeva, shefja e Departamentit të Studimeve Ballkanike; Nihat Ismayılzade, shefi i Departamentit të Projekteve Ndërkombëtare, në Universitetin Sllav të Bakusë. Delegacioni u shoqërua edhe nga prof. Lindita Latifi, pedagoge në Universitetin e Tiranës.

Nga ana e Akademisë së Shkencave, të pranishëm në takim ishin akad. Anila Hoda, sekretare shkencore; akad. asoc. Gëzim Hoxha, kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore Albanologjike; akad. Valter Memisha, drejtor i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë; prof. dr. Anila Omari, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë; prof. as. Adelina Çerpja, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë; prof. asoc. Elda Zotaj, drejtuese e Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë dhe Publikun.

Kryetari i Akademisë së Shkencave, akad. Skënder Gjinushi, i uroi mirëseardhjen rektorit, prof. Anar Naghiyev, ambasadorit z. Huseynov dhe anëtarëve të tjerë të delegacionit. Ai i njohu me vizionin, strukturën dhe funksionimin e Akademisë së Shkencave, zhvillimet më të fundit në fushën e kërkimit shkencor në këtë institucion, si dhe me mundësitë për bashkëpunime në fusha me interes të përbashkët. Në fjalën e tij

ai u ndal më gjatë në njohjen e delegacionit azerbajxhanas me institutet e albanologjisë dhe punën e tyre kërkimore-shkencore.



Rektori, prof. Anar Naghiyev, duke falënderuar për mikpritjen, e vlerësoi këtë takim si një mundësi për të nxitur dhe zhvilluar bashkëpunimin mes dy institucioneve. Në fjalën e tij përmendi rëndësinë që ka marrë zhvillimi i marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Azerbajxhanit, veçanërisht krijimi i urave të bashkëpunimeve me institucionet e arsimit të lartë shqiptar. Më tej, rektori, prof. Naghiyev, duke prezantuar Universitetin Sllav të Bakusë (BSU), theksoi se ai është universiteti publik më i njohur në Azerbajxhan për sa i takon studimit të gjuhëve dhe se Departamenti i Studimeve Ballkanike ka si synim ofrimin e studimit të gjuhës shqipe në vitin 2026. Ai theksoi më tej se kjo vizitë synon bashkëpunimin dhe konkretizimin e punës për hapjen e katedrës së gjuhës shqipe dhe ndërmarrjen e projekteve të përbashkëta e të shkëmbimit të stafëve kërkimore.

Ambasadori, z. Huseynov, shprehu kënaqësinë që ishte pjesë e këtij takimi dhe tha se vendi që ai përfaqëson ka në fokus rritjen e bashkëpunimit mes dy vendeve në shumë fusha, veçanërisht në fushën e bashkëpunimit kulturor dhe të shkencave humane.

Sipas tij, kjo ishte dhe arsyeja që para dy vjetësh u hap Ambasada e Azerbajxhanit në Republikën e Shqipërisë këtu në Tiranë. Ai foli për mundësinë e

lidhjes midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave të Azerbajxhanit, me mbështetjen e Ministrisë së Edukimit dhe të Shkencës në Azerbajxhan.



Takimi u përmbyll me një angazhim të palëve për të vazhduar përpjekjet për ndërtimin e një bashkëpunimi të qëndrueshëm dhe të frytshëm në fushën e shkencës dhe të arsimit, me fokus të veçantë në zhvillimin e studimeve të gjuhës shqipe dhe në forcimin e marrëdhënieve ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri dhe në Azerbajxhan.

U diskutua, gjithashtu, rëndësia e nënshkrimit të një marrëveshjeje bashkëpunimi, që do të mundësojë realizimin e projekteve konkrete, duke krijuar mundësi për shkëmbime akademike dhe kërkimore, si dhe për ngritjen e një katedre të gjuhës shqipe në Universitetin Sllav të Bakusë.

Kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi mirëpriti ftesën për të vizituar Bakun, duke theksuar angazhimin e Akademisë për të mbështetur çdo iniciativë që promovon dijen dhe bashkëpunimin ndërkombëtar e kontribon në ideimin e projekteve të përbashkëta. Po ashtu, vlerësoi rëndësinë e këtij takimi dhe mundësinë që ofron ai për forcimin e marrëdhënieve mes dy vendeve.

www.akad.gov.al

Aktivitete

Prof. dr. Dhorir Qirjazi mbajti dy ligjërata: "Të dhëna të reja për Fjalorin [italisht-]greqisht-shqip të Marko Boçarit" dhe "Për një botim të ri të 'Alipashiadës' së Haxhi Sheretit"



Sot, më 9 prill 2025, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u mbajtën dy ligjërata nga prof. Dhorir Qirjazi: "Të dhëna të reja për Fjalorin [italisht-]greqisht-shqip të Marko Boçarit" dhe "Për një botim të ri të 'Alipashiadës' së Haxhi Sheretit".

Veprimtaria u organizua nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Komisioni i përhershëm i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Shkencave. Ishin të pranishëm akad. Valter Memisha, drejtor i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë; prof. dr. Anila Omari, kryetare e Komisionit të përhershëm të gjuhësisë dhe të letërsisë, akademikë e studiues të IGJL-së, pedagogë të degës së gjuhës shqipe pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, anëtarë të Komisionit e pjesëmarrës të tjerë.

Prof. Qirjazi gjatë ligjëratës paraqiti historikun e hartimit dhe botimeve të veprës. Ai theksoi se përmes dokumenteve dhe studimeve të gjetura në arkiva e biblioteka, argumentimeve të studiuesve grekë dhe shqiptarë, shkrimeve të patriotëve rilindës e më gjerë, vendoset në një kuadër tjetër, më solid e më afër së vërtetës, kontributi i Marko Boçarit dhe i sulmëve të tjerë familjarë të tij në hartimin e një fjalori. Ai solli të dhënat e një studimi të D. Georgudis, 1995, i cili sjell prova se konsulli francez në

Janinë, F. Pouqueville, ishte mbështetur në një fjalor italisht-greqisht (Venecie, 1775, botimet A. Bortoli) nga i cili ka marrë fjalët që u kërkonte t'i përkthenin nga greqishtja në shqip grupit të suliotëve (M. Boçari me të atin, të ungjin dhe vjehrrin e vet), prandaj autori e quan fjalorin jo thjesht greqisht shqip, por [italisht]-greqisht-shqip. Në vijim të idesë së studiuesit Georgudis për një botim më utilitar në bazë të Fjalorit të Bortolit (1775), ku të merret prej aty pjesa italisht-greqisht që korrespondon me pjesën përkatëse të Fjalorit të Boçarit dhe paskëtaj të shtohen fjalët barazvlerëse të shqipes, prof. Qirjazi njofton se është në proces dhe në përfundim të kësaj pune, e cila e ndriçon edhe më shumë veprën e çmuar filologjike dhe gjuhësore të prof. Titos Johalas, botues me kritere shkencore i Fjalorit të M. Boçarit (1980) dhe studiues skrupuloz sidomos i kolonës shqip të tij.



Në ligjëratën e dytë, prof. Dhori Qirjazi foli për veprën “Jeta e Ali pashës nga Haxhi Shehreti”, njohur ndryshe edhe si “Alipashiada” dhe për nevojën e një botimi të ri të saj. Ai theksoi se vepra është një zhanër i eposit, që përveç vlerave dokumentare dhe historike, ku jepen të dhëna interesante për mënyrën sesi Ali Pasha e shihte veten si pasardhës dhe pasues të Pirros së Epirit, e më gjerë, përbën njëherësh edhe një burim të paçmuar të dhënash gjuhësore. Vepra është shprehje e një bilinguizmi kulturor klasik, ku në kuadër të një formacioni shtetëror polietnik (perandorie) gjuha burimore-amtare e një populli (këtu e popullit shqiptar) përdoret “brenda shtëpisë”, ndërsa në hapësirën publike përdoret gjuha zyrtare e shtetit, e perandorisë. Ajo përbën gjithashtu një dëshmi të klasit të parë të së folmes greqisht të Epirit dhe sidomos të greqishtes që flitnin asokohe dhe vazhdojnë të flasin sot banorët e zonave të Gjirokastrës, Delvinës dhe Sarandës, ata që i njohim sot si minoritarë.

Në fund të ligjëratës prof. Qiriazhi u shpreh se, tashmë që kemi një pamje më të plotë të të folmeve të Epirit dhe të kontakteve të greqishtes me shqipen, mund të ndërmerret ribotimi i plotë i veprës, duke ndrequr pasaktësitë apo lajthitjet e botimit të parë dhe duke shqyrtuar sërish dorëshkrimet e disponueshme, ndër të cilët njëri, ai i AQSH-së, deri sot i panjohur, merr vlerë të veçantë, dhe duke e shoqëruar botimin me një aparat kritik me natyrë kryesisht gjuhësore dhe filologjike, që do ta ndihmojë lexuesin për të rrokur kuptimin e pjesëve/shprehjeve/fjalëve përndryshe të pakuptueshme. Më tej mund të kalohet në një përkthim të ri të saj në gjuhën shqipe, a më saktë në një motërzim të ri, të plotësuar e të rishikuar, të përkthimit të I. Koçollarit.

www.akad.gov.al

U mbajt ligjërata me temën “Veçori tipologjike të sintaksës shqipe: rasti i nyjave të përparme” nga prof. asoc. Aristotel Spiro

Sot, më 29 prill 2025, u mbajt ligjërata me temën “Veçori tipologjike të sintaksës shqipe: rasti i nyjave të përparme” nga prof. asoc. Aristotel Spiro.



Veprimtaria u organizua nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Departamenti i gramatikës dhe i historisë së gjuhës, pjesë e ASHSH-së. Në këtë veprimtari morën pjesë akad. asoc. Gëzim Hoxha, Kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, ASHSH; prof. dr. Anila Omari, kryetare e Komisionit të përhershëm të gjuhësisë dhe të letërsisë, ASHSH; akad. Kristina Jorgaqi, si dhe studiues nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë dhe nga departamente të gjuhës në universitete të Shqipërisë etj.

Në ligjëratën e tij prof. asoc. Aristotel Spiro, pas një përshkrimi të disa dukurive tipologjike të gramatikës së shqipes, theksoi se gjuha shqipe, si pjesë e familjes indoevropiane, ka një pozicion të veçantë ndër gjuhët e tjera të rajonit dhe më gjerë, për shkak të krijimit të një sistemi të dyfishtë eptues emëror, që e bën të dallohet qartë nga gjuhët e tjera sintetiko-analitike.

Ai solli një analizë diakronike të zanafillës së gramatikalizimit të përemrave të dikurshëm dëftorë deri në përfundimin e nyjave të prapme e të përparme.

Studiuesi doli në përfundimin se gjuha shqipe karakterizohet nga një prirje për morfologjizim të strukturave sintaksore në masën që intuita gjuhësore i percepton këto si fakte morfologjike, ndërsa analiza e thellë dallon një realitet gjuhësor të ndryshëm, ku elementet klitike sillen si entitete gramatikore të veçanta, morfologjikisht të ndryshme,

por që janë të domosdoshme për të plotësuar pamjaftueshmërinë funksionale të emrave dhe sidomos të mbiemrave.



Kjo veçori i rezervon gjuhës shqipe një pozicion tipologjik të veçantë në grupin e gjuhëve sintetiko-analitike.

Kryetari i SSHSHA-së akad. asoc. Gëzim Hoxha përgëzoi autorin e ligjëratës për këndvështrimin interesant dhe theksoi nevojën që ligjërata të tilla duhet të zhvillohen më shpesh.

Nga të pranishmit fizikisht dhe virtualisht pati mjaft pyetje e diskutime rreth ligjëratës, por dhe rreth çështjeve të tjera gjuhësore të lidhura me të.

www.akad.gov.al

Departamenti i Studimeve Letrare, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, zhvilloi konferencën shkencore me tematikë letërsinë biografike dhe autobiografike shqipe

-Kjo veprimtari shkencore përfshiu studiuesit e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe të degës së Letërsisë pranë Institutit Albanologjik të Prishtinës



Sot, më 15 prill 2025, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u zhvillua konferenca shkencore me tematikë letërsinë biografike dhe autobiografike shqipe, e organizuar nga Departamenti i Studimeve Letrare, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, ASHSH, në bashkëpunim me degën e Letërsisë pranë Institutit Albanologjik të Prishtinës.

Në këtë konferencë ishin të pranishëm: drejtori i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë akad. Valter Memisha; përgjegjëse e Departamentit të studimeve letrare, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, ASHSH, prof. dr. Evalda Paci; drejtori i Institutit Albanologjik të Prishtinës, prof. dr. Naim Berisha; drejtori i degës së Letërsisë në Institutin Albanologjik të Prishtinës prof. dr. Gëzim Aliu; drejtori i Departamentit të Letërsisë pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi” në Shkodër: prof.asoc.dr. Arben Prendi, si dhe studiues që prej vitesh u kushtohen hulumtimeve të aspekteve të tipologjisë së kësaj letërsie, autorëve përfaqësues dhe reflektimeve përkatëse nga tradita tipike të

botës europiane.

Seanca u drejtua nga prof. dr. Evalda Paci, prof. asoc. Gëzim Aliu, dr. Virion Graçi.

Drejtori i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë akad. Valter Memisha, në fjalën përshëndetëse ceku historikun e bashkëpunimit mes IGJL-së, pjesë e ASHSH-së dhe Institutit Albanologjik të Prishtinës, si dhe nënvizoi rëndësinë e mbajtjes së kësaj veprimtarie shkencore që përfshiu në pjesëmarrje studiuesit e të dyja institucioneve. Ai tha se prej vitesh është vendosur një bashkëpunim i frytshëm i konkretizuar në veprimtari të ndryshme shkencore mbajtur në Prishtinë dhe Tiranë me orientim gjurmimet albanologjike, figura të shquara në historinë e studimeve shqiptare, leksikografinë shqipe, periodikun letrar e shkencor shqiptar, gjinitë letrare, kritikën letrare, etj. Më tej akad. Memisha premtoi organizime të frytshme në kuadër të projekteve të përbashkëta, nismave që shërbejnë për të kontribuar në kërkimet albanologjike dhe në fusha të ngushta të tyre.



Konferenca u përshëndet dhe nga prof. dr. Naim Berisha, drejtor i Institutit Albanologjik të Prishtinës, i cili e cilësoi si mjaft të vlefshme këtë veprimtari, si një tjetër nismë të konkretizimit të bashkëpunimit të sipërpërmendur.

Në këtë veprimtari shkencore u mbajtën kumtesa që kishin në qendër të vëmendjes pikërisht letërsinë biografike dhe autobiografike, kryesisht në letërsinë

shqipe, vështruar në disa periudha e qasje studimore.

Prof. dr. Hysen Matoshi (Instituti Albanologjik i Prishtinës) paraqiti kumtesën me temë “Ditari si autobiografi”, duke sjellë në ilustrim shembuj e modele nga tradita të përveçme letrare. Ai identifikoi autorë të ditarëve në letërsinë shqipe dhe atë botërore dhe theksoi se ditarët, përtej rëndësisë që kanë si pjesë e korpusit të gjerë letrar e kulturor, janë një trashëgimi shkrimore me interes të përgjithshëm shoqëror.

Akad. Memisha paraqiti kumtesën me titull “Kundrime autobiografike në veprën “Retë dhe gurët” (intervistë me vetveten të Petro Markos”. Ai përshkruan karakterin palimpsestor të veprës, në të cilën gjejmë tema të gjithë studiuesit dhe qëndroi në disa vëzhgime gjuhësore. Ai vuri në dukje se prurjet e shumta gjuhësore në këtë vepër kanë krijuar regjistra të formuar gjuhësisht dhe një spektër shprehjesh që të magjepsin si të jetë prozë e mirëfilltë artistike.

Prof. dr. Gëzim Aliu mbajti kumtesën "Autobiografi në letërsi". Ai tha se autobiografia mund të lexohet edhe si fakt edhe si letërsi e mirëfilltë (fiction). Studimin e tij prof. Aliu e fokusoi tek elementet narrative për të ndërtuar tekstin dhe dëshmitë letraro-artistike për jetën e autorit dhe botën ku jetonte. Analiza e tij u përqendrua në veprat biografike të Marin Barletit, Jeronim de Radës, Mitrush Kutelit, Migjenit, Faik Konicës, Nolit, Ismail Kadaresë e më gjerë. Ai argumentoi shndërrimin e tyre në personazhe letrare dhe figuracionin e narrativës letrare.

Prof. dr. Evalda Paci mbajti kumtesën me titull “Elemente të biografisë dhe të autobiografisë në përpilime të autorëve të letërsisë romake (vështrim mbi shqipërime e përshtatje)”. Ajo nënvizoi aspekte të profilizimit të letërsisë biografike në autorë e vepra të lashtësisë greke e romake, me një referim konkret ndaj shqipërimesh mbi këto të fundit. Prof. dr. Paci theksoi se në vështrim tipologjik e konstruktiv rreth kësaj letërsie gjurmohen prurje të shumta që dëshmojnë interesin e gjallë ndaj letërsisë antike greke, duke qenë kjo e fundit e pasur në subjekte dhe personazhe që ngjallin shtysa për vështrime të natyrës antropologjike dhe kritike. Ajo foli më tej për pasurinë e personazheve dhe subjekteve në letërsinë latine me trajtesa biografike të transmetuar në gjenerata në të gjitha format e mundshme të ruajtjes së veprës së shkruar.

Prof. asoc. Arben Prendi mbajti kumtesën me titull “Elemente biografizmi në romanet e Ridvan Dibrës dhe Stefan Çapalikut. Ai u ndal në aspekte të tipologjisë së shkrimtarisë së dy autorëve të rëndësishëm të letërsisë bashkëkohore shqipe dhe në vëzhgimin e elementeve biografike e autobiografike në veprat e tyre, të cilat përkojnë me një prirje të romanit bashkëkohor shqiptar për të bërë objekt të rrëfimit artistik traumat individuale dhe kolektive të jetës nën regjimin komunist dhe të tranzicionit shqiptar.

Prof. asoc. Adil Olluri (Dega e Letërsisë, Instituti Albanologjik i Prishtinës) u ndal në një vështrim kritik të studimeve të Agron Gashit mbi autobiografinë. Ai vuri në

dukje dhe risitë dhe pasurimin e studimeve përkatëse mbi këtë prirje të rëndësishme në letërsi. Gjithashtu, ai theksoi se shkrimi autobiografik letrar i dha letërsisë një frymë të tejshqeshme të raportit personal mes veprës dhe autorit të saj. Kjo mënyrë shkrimi i dha letërsisë një diskurs që e shndërron autorin në një personazh tejet të rëndësishëm të veprës së tij. Ngjyrimin personal në letërsi shenja e autobiografisë e bëri më transparente, më qenësore.



Dr. Virion Graçi (Departamenti i Studimeve Letrare, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, ASHSH) paraqiti kumtesën me temë “Vitalizim i romanit bashkëkohor shqiptar nga prurje autobiografike: raste e risi”. Ai trajtoi aspekte qenësore të reflektimit të kësaj letërsie në disa autorë të letërsisë shqipe, pa lënë jashtë vëmendjes dhe prurje referenciale mbi këtë tematikë nga autorë e vepra të letërsisë evropiane. Ai vuri në dukje se autobiografizmi në letërsinë bashkëkohore të çon menjëherë drejt një fondi përherë e në pasurim romanesh cilësorë, më përfaqësuesit dhe me besueshmëri e interes të veçantë në radhë të parë për publikun. Në dhjetëvjeçarët e fundit në letërsinë tonë kemi prurje të bollshme romanesh autobiografikë, të cilët shënojnë lartësi cilësore, jo vetëm sa i përket krijimtarisë autoriale, por edhe në fondin e krejt romanit shqip.

Meliza Krasniqi (Dega e Letërsisë, Instituti Albanologjik i Prishtinës) mbajti kumtesën “Letërsia si akt kujtese: Gratë që rikrijojnë heroinat”. Ajo trajtoi në veçanti shfaqje të elementeve biografike në autore të letërsisë dokumentare shqipe dhe theksoi se letërsia dokumentare dhe biografike është kthyer në një formë narrative të fuqishme

dhe të vlerësuar gjerësisht e të rrëfejë të vërteta historike përmes emocioneve dhe përjetimeve personale. Në këtë mënyrë ajo forcon lidhjen midis lexuesit dhe kujtesës historike, duke e bërë të kaluarën më të prekshme dhe më të kuptueshme.



Dr. Roven Vata (Departamenti i Studimeve Letrare, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, ASHSH) mbajti kumtesën me titull “Zëri biografik i Dritëro Agollit në poezinë e tij”. Ajo veçoi elemente të biografisë së këtij shkrimtari në disa krijime të mirënjohura të tij. Dr. Vata vuri në dukje se zëri biografik i Dritëro Agollit vjen me ngjyrim të theksuar sociologjik dhe filozofik, që në parim artistikisht, fuqizon njësinë e individuale në shërbim të së përgjithshmes.

Në përmbyllje të kësaj veprimtarie shkencore u mbajtën diskutime mbi vetë letërsinë biografike dhe shfaqjet e saj në tradita të caktuara letrare, si dhe mbi ndërlidhjen mes disiplinash të të shkruarit veçanërisht kur bëhet fjalë për një tematikë të tillë, përherë në pasurim dhe në qendër të vëmendjes studimore mbi zhvillimet letrare të kohëve të fundit.

www.akad.gov.al

Qendra e Studimit të Arteve zhvilloi sot një veprimtari për 95-vjetorin e lindjes së inxhinierit dhe historianit të kinemasë Abaz Hoxha

- Hoxha u vlerësua për ngritjen teknike të prodhimit të filmit shqiptar, punën e gjerë kërkimore në shkrimin e historisë së kinematografisë shqiptare dhe për themelimin e arkivës së filmit



Sot në datën 14 prill 2025, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë me rastin e 95-vjetorit të lindjes së inxhinierit dhe historianit të kinemasë Abaz Hoxha u zhvillua veprimtaria “Një jetë me kinemanë”. Kjo veprimtari u organizua nga Qendra e Studimit të Arteve, pjesë e ASHSH-së.

Veprimtarinë e përshëndeti drejtoresha e Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit, znj. Marinela Ndria. Ajo e vlerësoi z. Hoxha si një nga themeluesit e kinematografisë shqiptare dhe përshkroi disa nga arritjet kryesore në karrierën e tij të gjatë. Ai e nisi fillimisht si teknik i mesëm ndërtimi, më pas inxhinier elektronik dhe pas disa specializimeve për zërin në kinematografi në Pragë, ai punoi si inxhinier në Kinostudion “Shqipëria e re”. Pas shkatërrimit të saj në vitet ‘90, ai iu përkushtua punës si studiues dhe historian i kinematografisë. Abaz Hoxha është autor i 30 librave për

kinematografinë shqiptare dhe botërore dhe figurave përfaqësuese të tyre. Ai punon ende si pedagog i Akademisë së Arteve dhe i Akademisë "Marubi" të Filmit dhe Multimedias, ku jep lëndën e Historisë së kinematografisë botërore dhe shqiptare. Është anëtar i redaksisë së arteve dhe arkitekturës në Akademinë e Shkencave për hartimin e "Fjalorit enciklopedik shqiptar".

Më pas dr. Anxhela Çikopano moderoi veprimtarinë duke zhvilluar një bisedë me kineastin z. Hoxha, lidhur me jetën dhe trashëgimisë e lënë pas prej tij dhe historinë e kinemasë shqiptare.



Hoxha foli për të pranishmit lidhur me studimet për kinematografi në Pragë, të cilat i ndiqte paralelisht me studimet në degën e inxhinierisë. Më tej ai shprehu keqardhjen për rrënimin e Kinostudios "Shqipëria e re", të cilën e vlerësoi si një infrastrukturë të jashtëzakonshme në prodhimin e filmave për një vend në zhvillim si Shqipëria. Ai tha se vlerat e kësaj kinostudioje i ka shprehur në librat e tij, pa anashkaluar edhe problemet që kishte atje, ku prodhimin e filmave shpesh e pengonin intrigantët, spiunët, të paaftët, diletantët politikë, militantët servilë, që ishin pasoja të diktaturës. Megjithatë, ai theksoi se krijimtaria kinematografike shqiptare ka triumfuar. Periudha e Kinostudios "Shqipëria e re" ka qenë periudha më e ndritur, nga e cila kanë dalë regjisorë, aktorë dhe artistë të mëdhenj.

Dr. Çikopano e pyeti z.Hoxha për të shprehur opinionin e tij për problemet aktuale të kinemasë dhe filmit artistik shqiptar, si dhe për disa koncepte që lidhen me historinë dhe ndikimin e saj në artin kinematografik shqiptar, si dhe për kontributin që

ka dhënë për rivitalizimin e arkivave artistikë dhe për ndërtimin e Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit, një nga arkivat më të mirëmbajtura dhe më të aksesueshëm sot në Shqipëri.



Në fund të takimit, dr. Cikopano e falënderoi për punën skrupuloze si historian i kinematografisë, shkrimet e shumta në shtyp që nga viti 1972, që flasin për një punë kërkimore shumë të gjerë, dhe veçanërisht për punën e tij me rreth 400 dosje në Arkivin Qendror Shtetëror të filmit.

www.akad.gov.al

Qendra e Studimit të Arteve zhvilloi veprimtarinë me temën “Dëshmi për brezat që do të vijnë, krijimi i arkivit të emigracionit shqiptar në Greqi”

Qendra e Studimit të Arteve (QSA), pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, zhvilloi sot më 30 prill 2025 një bisedë të hapur me koordinatoren e Arkivit të Emigracionit Shqiptar në Greqi, Ilirida Musaraj.



Veprimtaria me temën “Dëshmi për brezat që do të vijnë, krijimi i arkivit të emigracionit shqiptar në Greqi” u çel nga dr. Anxhela Çikopano. Ajo vlerësoi rolin dhe ndikimin e projektit pilot “Arkivi i Emigracionit Shqiptar në Greqi” të ndërmarrë nga Arkivi i Historisë Sociale Bashkëkohore (ASKI) në Athinë, me mbështetjen e nismës për shkencat humane publike të Fondacionit Stavros Niarchos (SNFPHI) në Universitetin Columbia. Ky projekt shërbeu si një eksperiment në ndërtimin e arkivave bashkëkohore të emigracionit në Greqi.



Dr. Çikopano theksoi se synimi i kësaj veprimtarie është që të pasqyrojë burimet ekzistuese të emigracionit shqiptar drejt Greqisë, shpesh të anashkaluar.

Biseda me Ilirida Musaraj u drejtua nga studiuesja e QSA-së dr. Jonida Gashi.

Musaraj fillimisht foli për punën që është bërë e po bëhet gjatë procesit të ndërtimit të arkivit të Emigracionit Shqiptar në Greqi. Ajo paraqiti pjesë nga historia e këtij emigracioni përmes një koleksioni të pasur dëshmish; dokumente, fotografi dhe materiale personale.



Ndërkohë bashkëbisedimi u zhvillua lidhur me temat që përfshin ky arkiv mbi emigrimin shqiptar drejt Greqisë dhe përvojës së saj rreth emigracionit shqiptar në Greqi, si përjetimet e ndarjeve me familjet, vështirësitë ekonomike dhe ëndrrat për një jetë më të mirë.

Përmes kësaj veprimtarie dolën në pah të dhëna të rëndësishme, që lidhen me emigracionin, duke pasur në fokus krijimin e identitetit të brezit të dytë të emigrantëve shqiptarë që u lindën dhe u rritën në Greqi.

www.akad.gov.al

U mbajt leksioni i hapur me temën “Vdekja e (pa)shpjegueshme e teatrit radiofonik shqiptar”

Qendra e Studimit të Arteve, pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në bashkëpunim me Fakultetin e Artit Skenik (FAS) pranë Universitetit të Arteve (UART), në datën 23 prill 2025, organizoi leksionin e hapur me temën “Vdekja e (pa)shpjegueshme e teatrit radiofonik shqiptar”.

Veprimtaria u moderua nga prof. asoc. Alert Çeloaliaj, shef i departamentit dhe pedagog në Fakultetin e Artit Skenik.

Leksioni u mbajt nga studiuesja e teatrit e QSA-së dr. Anxhela Çikopano. Kërkimi studimor është realizuar në bashkëpunim me prof. as. dr. Majlinda Hala (UART) dhe është prezantuar në Simpoziumin Evropian të Historisë së Dramaturgjisë 2024, Budapest.

Në ligjëratën e saj, dr. Çikopano ndau me studentët e pedagogët historinë e zhanrit të teatrit radiofonik në Shqipëri, transmetimin e të cilit Radio Tirana e filloi zyrtarisht më 28 nëntor 1938. Ajo prezantoi disa nga shfaqjet e para në këtë zhanër, rrugën e zhvillimit, mbërritjen kulmore në vitet '70-'90, etj. Ecuria e teatrit radiofonik do të lidhej fort me zhvillimin e proceseve teknike në radio, të cilat pastaj do të sillnin të reja artistike.



Më tej, dr. Çikopano foli për specifikat e këtij zhanri të transmetuar drejtpërdrejt në radio, të përshtatjes së teatrit skenik për radio dhe teatrit radiofonik. Ajo theksoi se, edhe pse përdorej nga shteti si mjete propagande, Radio Tirana kishte programacion të larmishëm, ku gjeje edhe libra, sport, humor, histori dhe shfaqje teatri, që shumë

individë, për arsye të ndryshme, nuk mund t'i përjetonin në vetë të parë.



Pasi përshkoi uljet dhe ngritjet e zhvillimit të këtij zhanri në Shqipëri, dr. Çikopano theksoi se teatri radiofonik përjetoi shumë “vdekje prej heshtjes”, fillimisht në fund të regjimit dhe më pas me mbylljen e çdo tentative pas saj, që solli humbjen e gjithë përvojës dhe trashëgimisë së akumuluar. Megjithatë, teatri radiofonik vazhdon të jetë një domosdoshmëri për radion, për të zgjeruar ofertën e saj dhe për t’u përqendruar tërësisht te tingulli.



Në fund, dr. Çikopano paraqiti problematikat dhe sugjerimet për të ardhmen,

këto të fundit, të ngritura në bazë të një anketimi të gjerë online. Të pranishmit diskutuan rreth këtyre problematikave dhe dhanë sugjerimet e tyre.

www.akad.gov.al

Qendra për Koordinimin dhe Përhapjen e Informacionit Shkencor pranë ASHSH-së nisi ciklin e parë të trajnimeve për specialistët e rrjetit të bibliotekave të Shqipërisë të përfshira në sistemin COBISS



Në datën 7 prill 2025 Qendra për Koordinimin dhe Përhapjen e Informacionit Shkencor (QKPISH) në Akademinë e Shkencave nisi ciklin e parë të trajnimeve për specialistët e rrjetit të bibliotekave të Shqipërisë të përfshira në sistemin COBISS.

Trajnimet do të vijojnë në disa faza përgjatë vitit dhe janë rezultat i marrëveshjeve të bashkëpunimit midis Akademisë së Shkencave, institucioneve të arsimit të lartë (I.A.L.) dhe bibliotekave publike me vizion digjitalizimin dhe përhapjen e informacionit shkencor dhe akademik.

Në fazën e parë marrin pjesë drejtues dhe specialistë të bibliotekave shkencore, universitare, publike dhe speciale nga Tirana, Vlora, Korça, Shkodra, Durrësi, Berati etj.

<https://edu.cobiss.net/al/EntryFormDesktopDefault.aspx...>

Trajnimi synon kualifikimin e domosdoshëm të bibliotekarëve si specialistë të informacionit përmes përdorimit të sistemit **COBISS.AL** **<https://al.cobiss.net/>** dhe integritet të veprimtarisë kërkimore në sistemin **ECRIS.AL** **<https://cris.cobiss.net/ecris/al/sq>**

Module të veçanta do të përfshijnë digjitalizimin e njësive bibliografike në platformën dCOBISS dhe qasjen në informacion përmes elementeve që ndërthurin koncepte dhe metoda inovative të lidhura edhe me inteligjencën artificiale (shih linkun:

[https://plus.cobiss.net/cobiss/al/sq/bib/search/advanced...\).](https://plus.cobiss.net/cobiss/al/sq/bib/search/advanced...)

Ky proces është sfidues për të gjithë sistemin e informacionit shkencor në Shqipëri për zbatimin e standardeve ndërkombëtare që lidhen me rankimin e prurjeve shkencore.



Në trajnim marrin pjesë dhe punonjëset e reja të stafit të Bibliotekës së Akademisë së Shkencave pas riorganizimit të saj, në mbështetje të kërkimit shkencor, me fokus digjitalizimin e veprimtarisë botuese, transparencën dhe vlerësimin në platforma ndërkombëtare.

Në përfundim të trajnimeve, pjesëmarrësit do të pajisen nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë me licensat përkatëse. Ky është kusht i domosdoshëm për përdorimin e këtij programi dhe ndërveprimin midis bibliotekave në nivel kombëtar dhe në rajon.

www.akad.gov.al

U zhvillua në qytetin e Ulqinit konferenca shkencore “Ana e Malit nga lashtësia deri sot” në 20-vjetorin e shoqatës “ORA”



Në datën 12 prill 2025 u zhvillua në qytetin e Ulqinit konferenca shkencore “Ana e Malit nga lashtësia deri sot”.

Kjo konferencë u zhvillua me rastin e 20-vjetorit të shoqatës "ORA". Organizimi dhe realizimi i këtij aktivitetit shkencor u arrit me një cilësi dhe disiplinë të lavdërueshme shkencore dhe shënoi një ngjarje me rëndësi për krahinën e Anës së Malit.

Tematikat e trajtuara me kompetencë nga studiues nga Ana e Malit, Shqipëria dhe Kosova përfshinin shumë aspekte të jetës historike, sociale dhe kulturore të kësaj krahine me tradita shumë të vyera. Atje u paraqitën tema me shumë interes nga arkeologjia, historia, gjuhësia historike dhe krahasuese, gjeografia, demografia, turizmi apo personalitete shkencore të shquara të krahinës.

Në këtë aktivitet kontribuan edhe disa studiues nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë si akad. asoc. Gëzim Hoxha, prof. dr. Romeo Gurakuqi, dr. Ardian Muhaj dhe dr. Eduart Caka. Kjo pjesëmarrje është vijim i një tradite shumë të mirë të bashkëpunimeve të krijuara prej shumë vitesh. Punimet e këtij sesi shkencor do të përmbillen me një botim cilësor. Vlerat e pasqerueshme historike dhe kulturore të Anës

së Malit e lënë të hapur shtegun për të organizuar aktivitete të tjera jubilarë edhe në kohët e ardhshme. Akademia e Shkencave e Shqipërisë është dhe do të jetë përgjithmonë bashkëpunuese aktive në mbështetje të aktiviteteve të tilla vlerësuese dhe promovuese.

www.akad.gov.al

Akademie Aurela Anastasi prezantoi temën: “Çështje të metodave të kërkimit shkencor përmes “dialogut gjyqësor kushtetues””

-Prezantimi u zhvillua në Komisionin për çështjet ekonomike, juridike e sociale të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në kuadër të projektit: “Përafrimi i legjislacionit me standardet europiane përmes gjykimit kushtetues”, që zbatohet nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, financuar nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, (AKKSHI)



Në datën 16 prill 2025 në Komisionin për çështjet ekonomike, juridike e sociale të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë u zhvillua prezantimi me temë: “Çështje të metodave të kërkimit shkencor përmes “dialogut gjyqësor kushtetues”” nga akad. Aurela Anastasi.

Veprimtaria u zhvillua në prani të anëtarëve të Komisionit, si dhe të të ftuarve në sallën “Aleks Buda” dhe të pjesëmarrësve që u bashkuan online.

Akad. Anastas Angjeli, Kryetar i Komisionit dhe njëherazi drejtues i panelit, uroi mirëseardhjen dhe theksoi rëndësinë e temës që do të trajtohet në këtë mbledhje.

Akad. Aurela Anastasi prezantoi gjetjet paraprake të studimit për këtë çështje, duke theksuar rëndësinë e “dialogut gjyqësor” të Gjykatës Kushtetuese me Gjykatën Europiane të Drejtësisë, me gjykatat kushtetuese të vendeve anëtare të Bashkimit

European, si dhe të interpretimit krahasimor me legjislacionin e Bashkimit European. Kjo çështje është e lidhur ngushtë me kontrollin kushtetues të ligjeve, kur Shqipëria ndodhet në një fazë intensive të procesit për integrimin e saj në Bashkimin European. Vëmendje e posaçme iu kushtua metodës së studimit dhe të kërkimit në të Drejtën Kushtetuese të Krahasuar në kuadër të këtij dialogu.



Anëtarët e Komisionit dhe pjesëmarrësit e tjerë zhvilluan pyetje, diskutime e komente, duke u fokusuar në metodën e kërkimit, në konkluzionet e studimit dhe mënyrën e aplikimit të gjetjeve të tij në Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë, si edhe për zhvillimin e shkencave kushtetuese dhe të filozofisë të së Drejtës.

Diskutimet e zhvilluara në Komision përbëjnë një ndihmesë të vyer për hartimin e konkluzioneve përfundimtare të studimit të kryer. Studimi është hartuar në kuadër të projektit: “Përafrimi i legjislacionit me standardet europiane përmes gjyqimit kushtetues”, që zbatohet nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, financuar nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, (AKKSHI).

www.akad.gov.al

U zhvillua workshop-i me temën "Korniza referuese gjeodezike dhe modelimi i gjeoidit në Republikën e Shqipërisë"

-U prezantuan 4 punime shkencore nga specialistë të fushës, të vendit dhe të huaj, që kanë qenë pjesë e projektimit dhe implementimit të projekteve të KRGJSH-së

-Akad. Anila Hoda: Organizmi i kësaj veprimtarie është një shembull i shkëlqyer i qasjes strategjike të Akademisë së Shkencave për të promovuar kërkimin e avancuar në fushat që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetare dhe në qeverisjen e qëndrueshme të territorit



Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor(ASIG), në bashkëpunim me Departamentin e Gjeodezisë pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, Institutin e Gjeoshkencave (IGEO) dhe Laboratorin e Kërkimeve dhe Aplikimeve të Fushës Gavimetrike (GravLab) të Departamentit të Gjeoshkencave (DGS) të Universitetit "Aristotel" të Selanikut, zhvilloi më 17 prill workshop-in me temën "Korniza referuese gjeodezike dhe modelimi i gjeoidit në Republikën e Shqipërisë"

Veprimtarinë e çeli drejtori i Drejtorisë së Gjeodezisë dhe Hartografisë z. Kristaq Qirko.

Ai i falënderoi të pranishmit dhe organizatorët për pjesëmarrjen dhe ia dha fjalën sekretares shkencore të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Anila Hoda.

Në fjalën e saj përshëndetëse akad. Hoda theksoi se organizmi i kësaj veprimtarie me kontributin e institucioneve kërkimore brenda dhe jashtë vendit është një shembull i shkëlqyer i qasjes strategjike të ASHSH-së për të promovuar kërkimin e avancuar në fushat që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetare dhe në qeverisjen e qëndrueshme të territorit. Përmes këtij bashkëpunimi vendi ynë ka hedhur hapa të rëndësishëm drejt ndërtimit të një baze të unifikuar gjeodezike, të mbështetur në teknologjitë më të fundit dhe analizat gravimetrike të sakta, duke u pozicionuar si një vend në zhvillim të qëndrueshëm tekniko-shkencor.



Akademia e Shkencave në përputhje me misionin e lartë të saj si institucion i lartë kombëtar i kërkimit shkencor ka ndërmarrë vitet e fundit një proces të thellë riorganizimi institucional dhe strukturor. Ky proces ka sjell rikthimin e funksionit të saj si një qendër gjithëpërfshirëse e dijes dhe inovacionit. Në këtë kuadër janë integruar institutet e albanologjisë dhe janë krijuar qendra të reja kërkimore në fusha strategjike si bioteknologjia dhe gjenetika, nanoteknologjia, inteligjenca artificiale, pasuritë ujore, gjeoshkenca dhe gjeoinxhinieria. Këto njësi të reja kanë shërbyer si platforma për kërkime ndërdisiplinore dhe për aplikimin e teknologjive të avancuara në përputhje me prioritetet kombëtare të zhvillimit. Po kështu ka ngritur dhe forcuar rrjetin e komisioneve të saj të përhershme dhe të përkohshme në fusha të ndryshme, duke filluar nga mjekësia e bujqësia, në shkencat juridike, ekonomike dhe antropologjike, duke angazhuar personalitetet të njohura të shkencës shqiptare për të drejtuar e vlerësuar aktivitetet kërkimore në mënyrë të koordinuar dhe me cilësi të lartë.

Akad. Hoda nënvizoi më tej se kjo hapje strukturore dhe tematike e bën ASHSH-

në një partnere të hapur për bashkëpunime të gjera institucionale kombëtare dhe ndërkombëtare, e cila ka nxitur me vendosmëri bashkëpunimin ndërinstitucional përmes organizimit të konferencave, tryezave dhe projekteve shkencore.

Veprimtaria vijoi me prezantimin e implementimit të projekteve shkencore të nivelit të lartë në fushën e gjeodesisë dhe gjeodinamikës në tërësi, si dhe përfundimet e rëndësishme shkencore nga analiza e të dhënave të marra në terren gjatë kësaj periudhe.



Gjatë zhvillimit të dy seancave të kësaj veprimtarie u prezantuan 4 punime shkencore nga specialistë të fushës, të vendit dhe të huaj, që kanë qenë pjesë e projektimit dhe implementimit të projekteve të KRGJSH-së.

Oltjon Balliu, përgjegjësi i Sektorit të KRGJSH-së, ASIG, paraqiti projektin “Implementimi i Kornizës Referuese Gjeodezike Moderne në Republikën e Shqipërisë”.

Endri Qershija, përgjegjësi i Sektorit të ALBCORS-it, ASIG paraqiti projektin “Implementimi i Rrjetit Gjeodezik Aktiv (ALBCORS) në Republikën e Shqipërisë”.

Dr. Kristina Matraku, Instituti i Gjeoshkencave, paraqiti një studim për karakteristikat e zhvendosjes tektonike aktuale të Shqipërisë bazuar në të dhënat GNSS”.

Prof. Georgios S. Vergos – Universiteti i Aristotelit në Selanik paraqiti projektin “Modeli Gravimetrik dhe Hibrid i Gjeoidit në Republikën e Shqipërisë”

Workshop-i u zhvillua në kuadër të realizimit të Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), si Metadatë, i ndryshuar, si dhe miratimit të udhëzimeve dhe manualeve teknike në kuadër të standardizimit dhe harmonizimit të të dhënave gjeohapësinore.

Bazuar në këto akte ligjore, ASIG që nga viti 2014 u angazhua me hartimin e projekteve teknike të detajuara të nevojshme dhe implementimin e tyre për ndërtimin e rrjeteve në përbërje të KRGJSH-së, për t'i mundësuar Shqipërisë krijimin e bazës unike gjeodezike që mbështetet totalisht në teknologjinë GNSS dhe në llogaritjen e gjeoidit me rezolucion dhe saktësi të lartë për përcaktimin me efikasitet të pozicionit të saktë horizontal dhe vertikal të pikave të ndryshme në sipërfaqen e tokës, mbi /nën sipërfaqen e saj.



Në video: Pjesa e parë e workshop-it: "Korniza referuese gjeodezike dhe modelimi i gjeoidit në Republikën e Shqipërisë"

www.akad.gov.al

U zhvillua tryeza e rrumbullakët me temën “Kriobanka bimore "Akademia": e para në Shqipëri, rezultate dhe perspektiva”

Qendra e Kërkimit Shkencor “Bioteknologji & Gjenetikë” e Akademisë së Shkencave në datën 16 prill 2025 zhvilloi tryezën e rrumbullakët me temën “Kriobanka bimore "Akademia": e para në Shqipëri, rezultate dhe perspektiva”.



Kjo veprimtari u koordinua nga akad. Efigjeni Kongjika dhe prof. dr. Valbona Sota.

Në këtë tryezë u paraqitën rezultatet paraprake të ngritjes së Kriobankës në Qendrën e Kërkimit Shkencor “Bioteknologji & Gjenetikë” me qëllim ruajtjen e gjermoplazmës së pemëve autoktone me metoda të avancuara bioteknologjike in vitro.

Gjithashtu, u evidentuan edhe hapat e së ardhmes për kriokonservimin e gjermoplazmës së pemëve autoktone me metoda të reja të kriokonservimit, duke përfshirë varietete autoktone të tjera me vlera të rëndësishme dhe me mundësi të erozionit gjenetik dhe me procedura testimi fitosanitar dhe gjenetik.

Fjala përshëndetëse u mbajt nga akad. Ilia Mikerezi, kryetar i Komisionit biologji, bujqësi, veterinar.

Bashkëpunëtorët italianë, prof. Maurizio Lambardi dhe dr. Carla Benelli, IBE/Istituto per la BioEconomia - CNR, Firenze, Itali, pasqyruan punën e tyre shumëvjeçare në këtë drejtim.



Nga ekipi shqiptar u mbajtën prezantime dhe diskutime nga akad. Efigjeni Konkgjika, ASHSH; prof. dr. Valbona Sota, FSHN, UT; prof. asoc. Drida Carka, IRGJB, UBT; dr. Elektra Papakosta, QTTB, Vlorë; prof. dr. Magdalena Cara, UBT; prof. dr. Ariola Bacu, FSHN, UT; prof. dr. Jordan Merkuri, UBT, si dhe pjesëmarrës të tjerë të pranishëm.

www.akad.gov.al

U zhvillua simpoziumi me temën “Trashëgimia e ADN-së: Nga zbulimi në inovacionet e ardhshme”

Në datën 25 prill, në Ditën Botërore të ADN-së, Komisioni i biologjisë, bujqësisë dhe veterinarisë, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, zhvilloi një simpozium me temën “Trashëgimia e ADN-së: Nga zbulimi në inovacionet e ardhshme”.

Veprimtaria u organizua në saj të bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, përmes Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike dhe Komisionit të biologjisë bujqësisë dhe veterinarisë; departamentit të biologjisë pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Universitetit të Tiranës, si dhe Shoqatës Shqiptare të Gjenetikës Molekulare Humane.

Ishin të ftuar lektorë, ekspertë të gjenetikës në vend dhe përfaqësues të bizneseve që operojnë në fushën e bioteknologjive dhe testeve gjenetike.

Akad. Anila Hoda, sekretare shkencore e Akademisë së Shkencave, eksperte e fushës, u uroi mirëseardhjen të pranishmëve dhe i falënderoi për kontributin që sjellin në këtë festë të shkencës. Në fjalën përshëndetëse në emër të Kryesisë ajo theksoi se ASHSH-ja si institucioni më i lartë shkencor në vend ka një rol thelbësor në mbështetjen e kërkimit shkencor në fushën e gjenetikës. Në këtë drejtim, Qendra e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës, e ngritur pranë ASHSH-së, përfaqëson një strukturë të rëndësishme për zhvillimin e kërkimeve të avancuara në biologji molekulare për trajnim profesional dhe për nxitjen e zbatimeve të dijes në fushat jetike për shëndetin.



Më tej, akad. Hoda e vuri theksin tek misioni dhe qasja vizionare e ASHSH-së për

mbështetjen e brezit të ri shkencor. Akademia e Shkencave ka themeluar edhe Akademinë e të rinjve një nismë e dedikuar për fuqizimin e kërkuesve të rinj përmes aktiviteteve formuese; përfshirjes në projekte dhe krijimit të urave me akademitë dhe rrjetet ndërkombëtare të shkencës. Ajo theksoi se kjo veprimtari është një platformë edukimi, ndërgjegjësimi dhe frymëzimi. Pjesëmarrja e studentëve në diskutime dhe prezantime, si dhe përvoja e kërkuesve tanë e kthejnë këtë ditë në një hapësirë të gjallë bashkëbisedimi mes dijes dhe pasionit për shkencën.

Në fund, akad. Hoda përshëndeti veçanërisht prof. Doncho Donev nga Maqedonia e Veriut dhe prof. Peter McGrath nga Italia për ndarjen e përvojës së tyre në këtë aktivitet dhe për mbështetjen që i japin zhvillimit të shkencës dhe të rinjve në rajon.

Veprimtaria u moderua nga prof.dr. Mirela Lika (Cekani) përgjegjëse e Grupit mësimor kërkimor gjenetikë- mikrobiologji, Departamenti i Biologjisë, FSHN dhe zv. presidente e Shoqatës Shqiptare të Gjenetikës Molekulare Humane dhe prof. dr. Etleva Hamzaraj, zv. dekane për kërkimin shkencor, FSHN, Departamenti i Biologjisë.



Prof. dr. Lika ftoi kryetarin e Komisionit të biologjisë dhe veterinarisë, akad. Ilia Mikerezin që të mbante një fjalë përshëndetëse, duke e vlerësuar si një nga ekspertët më të specializuar në fushën e gjenetikës.

Akad. Mikerezi e vuri theksin tek rëndësia e të dhënave gjenetike. Ai u shpreh se të dhënat gjenetike hedhin dritë në historinë e njerëzimit dhe foli për të dhëna të reja të marra nga ADN-ja e zbulimeve të lashtësisë, të cilat tregojnë historinë e migrimeve të popullatave të lashta. Ai shprehu mirënjohjen për zbuluesit dhe përmendi historinë e zbulimeve të para gjenetike që nisin me heliksin e dyfishtë të ADN-së në vitin 1953 nga Watson, e vijojnë me përfundimin e Projektit të Gjenomit Njerëzor në vitin 2003.

Gjithashtu, ai solli në vëmendje të të pranishmëve faktin e zbulimit të mëtejshëm të gjeneve të tipareve që nuk njiheshin më parë. Ai tha se zbulimi i ADN-së është nga zbulimet më transformuese. Zbulimet mbi ADN-në dhe në tërësi mbi fushën e gjenetikës dhe biologjisë molekulare kanë bërë të mundur implementimin e tyre në diagnostikimin e sëmundjeve kanceroze apo të sëmundjeve gjenetike dhe falë hulumtimeve në dekadat e fundit dhe zhvillimin e inxhinierisë gjenetike dhe terapisë gjenike.



Forumin e përshëndeti edhe prof. asoc. Merita Xhetani, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Gjenetikës Shqipëri (ASHMG), Presidente e Shoqatës Shqiptare të Gjenetikës Molekulare Humane dhe koordinatore e projektit. Ajo bëri prezantimin e studimit me temë "Heliksi i dyfishtë dhe ndikimi i tij në shkencën moderne".

Seanca plenare vijoi me prezantime të disa temave si: Gjenetika molekulare, shkenca biomjekësore dhe shëndeti publik, që u trajtua nëpërmjet një studimi të rastit për sëmundjet e rralla në Maqedoni" nga dr. Donço Donev; "Heliksi me dy tehe: ADN, AI dhe sfida e biosigurisë" që u prezantua nga dr. Peter McGrath, InterAcademy Partnership, TWAS, Trieste, Itali; Sëmundja mendore dhe zhvillimet në biologjinë molekulare" që u prezantua nga prof. dr. Anila Mitre; përdorimi i STR-ve për identifikimin e njerëzve në fushën e mjekësisë ligjore" që u prezantua nga dr. Ela Zaimi, Instituti i Policisë Shkencore, Tiranë.

Në fund, prof. asoc. Etleva Hamzaraj paraqiti konkluzionet e simpoziumit. Pas kësaj u bënë diskutimet për promovimin e kërkimit në gjenetikë, forcimin e politikave shkencore dhe ndërgjegjësimin e publikut për rëndësinë e biologjisë molekulare në

shëndetësi dhe inovacion, si dhe angazhimin e të rinjve dhe studentëve në hulumtimin dhe qasjet e reja në fushën e Gjenetikës, për të qenë konkurrues me bashkëmoshatarët e tyre në Europë e më gjerë.

www.akad.gov.al

Prof. asoc. Selami Xhepa prezantoi një ligjëratë me temën “Sistemet e inovacionit: një vështrim krahasues”

-Prezantimi u zhvillua për diskutim dhe debat në Komisionin për çështjet ekonomike, juridike e sociale të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë-



Prof. asoc. Selami Xhepa prezantoi për diskutim në Komisionin për çështjet ekonomike, juridike e sociale të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë studimin me temën “Sistemet e inovacionit: një vështrim krahasues”.

Veprimtaria u zhvillua në datën 17 prill 2025, në prani të anëtarëve të Komisionit në sallën “Akademikët”, ASHSH.

Akad. Anastas Angjeli, Kryetar i Komisionit u uroi mirëseardhjen dhe theksoi rëndësinë e temës që do të trajtohet në këtë mbledhje, duke u fokusuar në kontekstin shqiptar.

Prof. asoc. Selami Xhepa prezantoi tezat për inovacionin dhe R&D si burim kryesor i rritjes ekonomike, të cilat fokusohen në çështjet e lidhura ngushtë me raportin e Shqipërisë kundrejt vendeve konkurruese (rajonit) dhe largësia nga BE-ja në disa nga treguesit kryesor të konkurrueshmërisë, si dhe në politikat dhe instrumentet e ndërhyrjeve publike.

Në këtë prezantim u trajtuan problematikat e strukturës ekonomike, si: mungesa

e planeve të integruara në politikat industriale; mungesa e kriterëve dhe objektivave për mbështetje publike dhe perspektivat për ndryshimin; nevoja për një politikë të re industriale, ku procesi vetë duhet të jetë i strukturuar me një dokument integral dhe rrjet institucionesh etj.



Anëtarët e Komisionit dhe pjesëmarrësit e tjerë shtruan pyetje dhe diskutuan për disa çështje të trajtuara nga prof. Selami Xhepa, duke përfshirë dobësitë e tranzicionit, integrimin e dobët në zinxhirin global të vlerës – veçanërisht të manifakturës, strukturën ekonomike me dominim nga aktivitete me vlerë të ulët të shtuar, ndryshimet demografike dhe presionin mbi tregun e punës, zhvillimet pas pandemisë dhe ato aktuale gjeopolitike.

www.akad.gov.al

Komisioni i Mjekësisë, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, zhvilloi tryezën e rrumbullakët “Autizmi në Shqipëri”



Komisioni i Mjekësisë pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në datën 15 prill 2025 organizoi një tryezë të rrumbullakët me temë: “Spektri i Autizmit dhe problemet aktuale të lidhura me të në Shqipëri”.

Ky aktivitet i zhvilluar në kuadër të planit vjetor të veprimtarive shkencore të Komisionit u drejtua nga kryetari i Komisionit të mjekësisë, akad. Genc Sulçebe, i cili theksoi rëndësinë e kësaj problematike në rritje dhe nevojën për një trajtim multidisiplinar dhe të koordinuar.

Nisma për këtë veprimtari u propozua nga prof. Albana Fico, e cila theksoi rëndësinë e ndërhyrjes së hershme dhe bashkërendimit të punës ndërmjet specialistëve të ndryshëm për diagnostikimin dhe trajtimin e fëmijëve me çrregullime të spektrit autik (ASD).

Të ftuar specialë dhe raportues në këtë tryezë ishin dr. Florida Dobi, drejtore e Qendrës Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët (QKTRF), dhe prof. dr. Ariel Çomo, specialist në fushën e shëndetit mendor dhe kërkimeve mbi autizmin.

Dr. Dobi ofroi një panoramë të gjerë mbi institucionet që ofrojnë shërbime për fëmijët me ASD në Shqipëri, si dhe sfidat kryesore me të cilat përballen familjet dhe profesionistët në këtë fushë.

Ajo theksoi:

Mungesën e protokolleve të standardizuara për diagnostikim dhe trajtim; Nevojën për pajisje me instrumenta bashkëkohorë vlerësimi si ADOS; Mungesën e stafit të trajnuar në mënyrë të njëtrajtshme në të gjithë vendin; Mbingarkesën e qendrave ditore dhe mungesën e shtrirjes gjeografike në zona rurale; Nevojën për krijimin e qendrave satelitë sipas modelit të QKTRF; Domosdoshmërinë për hartimin e protokolleve të specializuara rehabilituese në fusha të ndryshme: logopedike, psiko-motorike, edukim special, terapi grupi dhe okupacionale.



Dr. Dobi theksoi gjithashtu se identifikimi i hershëm i rasteve – që në fazën e konsultorit të nënës dhe fëmijës – është kyç për ndërhyrjen efektive dhe të suksesshme.

Prof. Çomo analizoi situatën nga këndvështrimi i të dhënave epidemiologjike dhe ekonomiko-financiare. Ai vlerësoi se në Shqipëri mund të ketë mbi 6000 deri në 14.000 fëmijë me autizëm, ndërkohë që sistemi shtetëror identifikon vetëm rreth 2500 raste që përfitojnë KEMP, nga të cilët rreth 1500 me kujdestari.

Ai theksoi disa problematika të rëndësishme:

Rreth 40 milionë euro në vit shpenzohen nga familjet jashtë sistemit publik për terapi dhe shërbime mbështetëse; Shumë nëna dalin nga tregu i punës për të kujdesur për fëmijët; Shpenzimet për terapi dhe mësues mbështetës arrijnë mesatarisht në 10,000 euro në vit për familje; Mungesë e infrastrukturës kërkimore dhe diagnostike; Fragmentarizimi i qendrave terapeutike dhe mungesa e një databaze të unifikuar.

Ndër rekomandimet e dhëna prej tij përfshihen: shtrirja e shërbimeve në të gjithë vendin, organizimi në njësi të vogla funksionale, dhe rritja e investimeve në infrastrukturë dhe burime njerëzore për diagnostikim dhe kërkime shkencore.

Tryeza u vlerësua nga pjesëmarrësit si një moment i rëndësishëm për reflektim dhe propozime konkrete në drejtim të forcimit të politikave publike për autizmin në vendin tonë.

Akademia e Shkencave do të vazhdojë të promovojë shkencën dhe debatin profesional mbi temat me impakt të lartë shëndetësor dhe social.

www.akad.gov.al

Njësia e përkohshme e kërkimeve gjeografike zhvilloi veprimtarinë e parë shkencore

Në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u mbajt më 24 prill 2025, tryeza e rrumbullakët me temën “Studimet gjeografike mbi natyrën, shoqërinë dhe vendbanimet tona – pjesë e pandarë e albanologjisë, me qasje në sqarimin dhe argumentimin shkencor të shumë problemeve të saj”.

Kjo veprimtari u organizua nga Njësia e përkohshme e kërkimeve gjeografike, pjesë e ASHSH-së. Morën pjesë profesorë dhe pedagogë të gjeografisë nga disa universitete të vendit, publike e private; dhe profesorë e studiues të shkencave të afërta me gjeografinë. E pranishme ishte edhe kryetarja e bashkisë së Roskovecit, dr. Majlinda Bufi.

Në fjalën përshëndetëse, akad. Neki Frashëri, Kryetari i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike, në emër të Kryesisë së ASHSH-së, përgëzoi pjesëmarrësit e këtij forumi për kërkimet shkencore, duke konkretizuar edhe nisjen e mbarë të punës së Njesisë së përkohshme të kërkimit gjeografik, e cila u zyrtarizua para pak javësh (më 6 mars 2025).



Objekti i diskutimeve të kësaj tavoline synon të drejtojë studimet gjeografike drejt Albanologjisë, me theks sqarimin e argumentimin shkencor në këndvështrimin

gjeografik të shumë problemeve dhe tezave të saj.

Prof. dr. Dhimitër Doka drejtoi tryezën shkencore. Fillimisht ai falënderoi pjesëmarrësit e ardhur nga institucionet e Tiranës dhe nga universitetet e rretheve për praninë dhe kontributin e tyre në veprimtarinë e parë shkencore të Njesisë së përkohshme të kërkimeve gjeografike. Gjithashtu, ai shprehu mirënjohjen për prof. dr. Perikli Qiriazin, drejtuesin e Njesisë së kërkimit gjeografik, si dhe të gjithë kolegëve të tjerë themelues dhe mbështetës të kësaj njësie, e cila do të funksionojë për të mbajtur të gjitha kontributet e arritura dhe për t'i thelluar e çuar më tej ato, në një kohë që natyra jonë po përballet me ndryshime shumë të shpeshta dhe të parashikuara më parë, siç janë ndryshimet klimaterike dhe efektet e tyre; tjetërsimi dhe ndotja gjithnjë e më madhe e ambientit natyror, presioni human dhe menaxhimi i territorit etj. Po kështu shumë zhvillime demografike dhe sociale të vendit tonë këto tri dekadat e fundit nxjerrin gjithnjë e më shumë nevojën që ato të jenë në vazhdimësi në fokusin e studimit të tyre gjeografik.



Në fjalën e tij prof. dr. Perikli Qiriazin theksoi se një nga detyrat dhe synimet e mëdha të studimeve gjeografike komplekse e gjithëpërfshirëse për natyrën, shoqërinë, vendbanimet, trashëgiminë tonë natyrore e kulturore dhe shumë objekte të tjera gjeografike, është integrimi i tyre në fushën e Albanologjisë dhe forcimi i ndërveprimit me disiplinat e tjera. Ky ndërveprim ndihmon në sqarimin dhe argumentimin shkencor të shumë çështjeve dhe problemeve albanologjike. Gjeografia, me objektin e saj të gjerë

studimor dhe me risitë e shumta metodologjike të vlerësimit shkencor të resurseve natyrore e njerëzore, përmes GIS-it, teknologjive gjeohapësinore, instrumenteve e teknikave për analiza hapësinore dhe eksplorime virtuale, mundëson analiza përgjithësuese shkencore, që i shërbejnë edhe zgjerimit e thellimit të studimeve albanologjike, forcimit të ndërveprimit të saj me disiplinat e tjera shkencore të afërta.



Në kuadër të këtyre problematikave, në këtë veprimtari shkencore u prezantuan tri studime nga prof. dr. Bilal Draçi, prof. dr. Pal Nikolli dhe prof. asoc. dr. Jostina Dhimitri, të cilat lidhen me studimet gjeografike mbi vendbanimet shqiptare; hartografinë historike në albanologji, si dhe këndvështrimet studimore gjeohistorike, metodologjike e modelet orientuese.

Gjatë prezantimit të punimeve shkencore nëpërmjet qasjeve kritike dhe argumentimit shkencor u demonstruan stereotipat, u sqaruan paradokset dhe u ofruan platforma të reja për të kuptuar sfidat që hasin rajonet tona: nga shfrytëzimi i burimeve natyrore dhe menaxhimi i rreziqeve mjedisore, deri tek dinamikat demografike dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore të vendbanimeve shqiptare.

Në diskutimin e saj dr. Majlinda Bufi, foli për rëndësinë e aktivitetit dhe theksoi problemet e bashkisë së Roskovecit, zgjidhja e të cilave kërkon bashkëpunim me studiuesit gjeografë. Tërhoqi vëmendjen projekti për kthimin e rezervuarit të madh të Kurjanit në një aset turistik. Për të mos u përballur me probleme natyrore e sociale, ajo theksoi se duhet të kryhet studimi gjeografik.

Takimi u ndoq me interes nga të gjithë pjesëmarrësit, të cilët në diskutimet e tyre

dhanë ide dhe mendime shumë të vlefshme për punën e mëtejshme.



Diskutuan profesorët Zydi Teqja, Hajri Hasko, Romeo Eftimi, Vasil Kristo, Valbona Duri, Thoma Shkira, Niko Rogo, Marenglen Sherifi etj.

Në fund, u bënë konkluzionet e veprimtarisë nga drejtuesi i saj prof.dr. Dhimiter Doka.

Lajm për veprimtarinë ne gazetën "SOT":

<https://sot.com.al/.../studimet-gjeografike-mbi-natyren.../>
www.akad.gov.al

Jubile akademik

**Akademia e Shkencave dhe kryesia e saj i urojnë akademikes Aurela Anastasi:
Gëzuar 60-vjetorin e lindjes!**



Akademia e Shkencave dhe kryesia e saj, Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike dhe kolegët i urojnë akademikes Aurela Anastasi:

Gëzuar 60-vjetorin e lindjes! Jetë të gjatë dhe suksese në krijimtari!

Akad. Aurela Anastasi është anëtare e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, profesoreshë e të drejtës kushtuese dhe aktiviste e shquar e shoqërisë civile.

Lindi më 7 prill 1965 në Vlorë. Ajo ka dhënë kontributin e saj për zhvillimin e institucioneve dhe të së drejtës shqiptare në raport me standardet më të përparuara të së drejtës ndërkombëtare.

Akad. Anastasi është autore e studimeve me karakter historik, duke aktualizuar dobishmërinë e tyre në lidhje me zbatimet në praktikë të legjislacionit të ri shqiptar dhe të jurisprudencës gjyqësore, ku ka dhënë një ndihmesë të veçantë edhe përmes përfaqësimit si avokate në raste gjyqësore strategjike për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe përmes analizës së vendimeve gjyqësore. Ajo ka drejtuar dhe ka marrë pjesë në projekte studimore, kombëtare e ndërkombëtare. Është një nga themelueset dhe hartueset e lëndës “E drejta kushtetuese e krahasuar”, “Barazia gjinore dhe ligji”, si dhe e disa prej disiplinave mësimore që zhvillohen në programet “Master” dhe “Doktoraturë” dhe bashkautore e teksteve mësimore. Ka botuar artikuj studimorë në

revista shkencore kombëtare e ndërkombëtare; ka realizuar referate e kumtesa në aktivitetet shkencore, si brenda edhe jashtë vendit; ka ligjëruar si pedagoge vizitore në disa universitete, brenda dhe jashtë vendit. Është anëtare e redaksive botuese në disa revista shkencore. Është njohëse e tri gjuhëve të huaja, anglisht, frëngjisht, italisht.

Akad. Anastasi është zgjedhur për dy mandate rresht përgjegjëse e departamentit të së drejtës publike në Fakultetin e Drejtësisë në UT, ndërsa në periudha afatshkurtra është emëruar zv.dekane e dekane e këtij fakulteti. Ajo është pedagoge e jashtme dhe eksperte në trajnimin vazhdues të gjyqtarëve dhe prokurorëve pranë Shkollës së Magjistraturës, si dhe e avokatëve pranë Shkollës Kombëtare të Avokatisë. Është iniciatore dhe drejtuese e disa aktiviteteve shkencore për të rinjtë juristë dhe e krijimit të organizatave pro bono të studentëve të Fakultetit të Drejtësisë, me qëllim ofrimin e ndihmës ligjore falas për shtresat në nevojë.

Ka qenë anëtare në disa komisione dhe ka drejtuar disa grupe pune në kuadrin e reformave kushtetuese e ligjore kombëtare. Ka spikatur në inicimin, hartimin dhe lobimin e paketës së ligjeve të barazisë gjinore në shoqëri, për mbrojtjen nga diskriminimi dhe për mbrojtjen nga dhuna në familje. Ka qenë ndër hartueset e marrëveshjeve të komuniteteve fetare me Këshillin e Ministrave.

Nga viti 2004 e në vijim është zgjedhur në forumet drejtuese të Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe pedagoge pranë Shkollës Kombëtare të Avokatisë. Është anëtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Konstitucionalistëve (nga viti 2014), si dhe anëtare e “Komisionit European për Demokraci nëpërmjet Ligjit”, Komisionit të Venecias në emër të Shqipërisë (2016-2020).

www.akad.gov.al

In memoriam

“Fizika në shekullin XXI”, veprimtari përkujtimore për fizikanin e shquar akademik Artan Boriçi

- Në këtë veprimtari akad. Artan Boriçi u vlerësua jo vetëm si një fizikan brilant, por edhe si një njeri i madh në përmasat e dijes dhe integritetit



Në datën 16 prill 2025 u zhvillua veprimtaria përkujtimore “Fizika në shekullin XXI” për fizikanin e shquar akademik Artan Boriçi, e organizuar nga Instituti Kombëtar i Fizikës, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, dhe Departamenti i Fizikës, Universiteti i Tiranës.

Në këtë veprimtari morën pjesë akad. Skënder Gjinushi, kryetari i Akademisë së Shkencave; anëtarë të kryesisë së ASHSH-së; prof. dr. Eglantina Kalluçi, dekanë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës; akad. Mimoza Hafizi, drejtore e Institutit Kombëtar të Fizikës, ASHSH; familjarë të akademikut Artan Boriçi, studiues, kolegë, studentë që kanë mbrojtur doktoraturën dhe kanë marrë mësim nga akad. Boriçi.

Akad. Anila Hoda, sekretare shkencore e Akademisë së Shkencave, mbajti një fjalë përkujtimore në emër të Kryesisë. Ajo përshëndeti të pranishmit dhe veçanërisht familjarët e akad. Artan Boriçit. Në fjalën e saj ajo theksoi se në këtë ditë të veçantë

kujtohet dhe nderohet me përulësi dhe mirënjohje një prej mendjeve më të ndritura të shkencës shqiptare, kolegu i dashur, akademiku Artan Borici, i cili, po të ishte mes nesh, do të festonte 60-vjetorin e lindjes. Më tej shprehu vlerësimet për përkushtimin e veçantë të akad. Boriçit në shkencën e fizikës. Ai kontribuoi pa zhurmë, me modesti të rrallë, në themelimin e një shkolle të re kërkimore në vend dhe la pas një trashëgimi që do të vazhdojë të frymëzojë breza të tërë studiuesish.



Dekania e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, prof. dr. Eglantina Kalluci, vlerësoi kontributin shkencor të akademik Artan Boriçit dhe theksoi se puna kërkimore-shkencore e tij ishte avangardë jo vetëm për kohën, por ai ishte i pari që futi nocione, të cilat ende sot mbeten të reja për grupin e studiuesve. Ai ka lënë gjurmë që na kanë bërë krenarë për punën dhe veprën e lënë pas.


Në këtë veprimtari u prezantuan punimet shkencore, duke kujtuar kontributin e akad. Boriçit në jetën akademike, marrëdhënien me kolegët dhe mbështetjen që ai u ka dhënë brezave të rinj të studiuesve.

Akad. Mimoza Hafizi paraqiti një punim me temën “Zbulimi i jetës jashtëtokësore-Sfida e shekullit të 20-të”. Ajo theksoi se zgjedhja për të zhvilluar këtë veprimtari shkencore është bërë që kujtimi i Artan Boriçit të ndërtohet përmes ngjarjeve më madhore që po përjeton fizika e shekullit ku ai jetoj dhe kontribuoi si një fizikan i shquar. Sfida e zbulimit të jetës jashtëtokësore ishte e preferuara e tij. Akad. Hafizi u

ndal në temën e ekzoplanetëve për të përkujtuar akad. Boriçin, i cili 6 vjet më parë ishte bashkorganizator i një veprimtarie të ASHSH-së lidhur me ekzoplanetët dhe zbulimin e tyre. Më tej ajo foli për profilin e shkencëtarit Boriçi si studiues i shquar i mikrobotës së bërthamës e të grimcave elementare dhe për kontributin që ka dhënë në veprimtaritë shkencore të ASHSH-së e më gjerë.

Prof. asoc. Rudina Osmanaj (Departamenti i Fizikës, Universiteti i Tiranës) rrëfeu për punën e madhe dhe sfidat e tij në shkencë, dhe më pas paraqiti punimin “Në botën e fermioneve rrjetore. Fermionet minimalisht të dubluara”. Në këtë punim ajo u përqendrua te kromodinamika kuantike.

I biri i akad. Artan Boriçit, Dalin Boriçi, i cili është i diplomuar në matematikë e fizikë në Francë dhe që po ecën në gjurmët e të atit, përshëndeti online pjesëmarrësit në këtë veprimtari. Ai prezantoi një punim për izolatorët topologjikë në prani të fushës elektrodinamike kuantike, fushë studimi që e ka ndjekur falë pasionit që kishte edhe i ati, akad. Boriçi.



Tre ish-studentë të akad. Boriçit rrëfyan kujtimet, ndihmën që u ka dhënë në udhëtimin e tyre në rrugën e shkencës dhe më pas prezantuan kërkimet shkencore: Giulio Boraka prezantoi punimin “Bazat fizike të relativitetit të përgjithshëm”; dr. Florian Milo prezantoi studimin me temën “Bashkëveprimi magneto-akustik për

llogaritje kuantike” dhe Sergei Çelaj prezantoi një studim për pikat kuantike të integruara në mikrostruktura polimeresh për studimin e efektit laser.

Prof. dr. Dod Prenga (Departamenti i Fizikës, Universiteti i Tiranës) prezantoi studimin “Kërkimi dhe teknikat llogaritëse në Departamentin e Fizikës”. Duke cekur arritjet e këtij departamenti, i cili është diversifikuar në disa drejtime, dhe mbulohen kërkime doktorale të një diapazoni të gjerë si studime të parametrave fizikë, analizë dhe përpunim të të dhënave, studime në sisteme biofizike, si dhe simulim-modelime ndërdisiplinare, ai ia kushtoi këto arritje punës së madhe të akad. Boriçit. Ai u kujtoi të pranishmëve se në mesin e viteve 2000 u bë pjesë strukturore e Departamentit të Fizikës Grupi i Fizikës Llogaritëse drejtuar nga prof. Artan Boriçi, entitet që energjizoi dukshëm në sasi dhe cilësi punimet që bazohen ose aplikojnë teknika të avancuara llogaritëse dhe simulime. Prof. dr. Prenga vlerësoi më tej edhe faktin që të diplomuarit që kanë vijuar specializimet jashtë apo janë larguar pas viteve ‘90, e kanë pasuruar traditën me suksesin e tyre në institucionet kërkimore dhe universitetet ku janë atashuar, duke certifikuar pa mëdyshje nivelin e arrirë në shkollimin e këtushëm.

Dr. Aleksandër Çipa prezantoi punimin “Artani në shtypin shqiptar”, përmes të cilit dha një pasqyrë të plotë të kontributit të akad. Boriçit në gazetari. Ai i vlerësoi shkrimet e tij për qasjen analitike dhe idetë që jepte për zgjidhjen e problemeve, duke u përfshirë në të gjitha tematikat sociale, politike e shkencore. Dr. Çipa e vuri theksin te roli i akad. Boriçit me shkrimet për çështje të arsimit e shkencës shqiptare.

Në fund, dr. Mirela Boriçi, bashkëshortja e akad. Boriçit, falënderoi Kryesinë e Akademisë së Shkencave dhe organizatorët e veprimtarisë shkencore që u zhvillua në nderim të 60-vjetorit të akad. Boriçit. Pasi shprehu mirënjohjen, dr. M. Boriçi mbajti një kumtesë me titull “Përse të bëhemi fizikanë?”, përmes së cilës hodhi dritë në mesazhet që ka lënë akad. Artan Boriçi. Ai e çmonte shkencën e fizikës për ndikimin dhe rëndësinë e madhe që ka jo vetëm në fushat e shkencës, por edhe në ekonomi, industri, e sfera të tjera të jetës.

Akad. Artan Boriçi ka dhënë kontribute të rëndësishme në studimet e fizikës teorike. Ai është një prej pionierëve të rëndësishëm që ka shtyrë përpara metodologjitë e reja llogaritëse në LQCD dhe është i pari që u orientua drejt paraqitjeve ekzakte të fermioneve kirale në rrjet dhe simulimin e tyre. Në funksionet e tij si kërkues i mirënjohur dhe fizikan akad. Boriçi ka treguar qartë kompetencën më të lartë shkencore.

www.akad.gov.al

Ndahet nga jeta aktorja e mirënjohur shqiptare Margarita Xhepa

-Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Komisioni i Përhershëm i Arteve pranë Akademisë së Shkencave u përcjell ngushëllime familjarëve, kolegëve e miqve të saj-



Me dhimbje të thellë Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Komisioni i Përhershëm i Arteve përcjell ngushëllimet për ndarjen nga jeta të aktores Margarita Xhepa, një figurë madhore e teatrit dhe ekranit në hapësirën mbarëshqiptare.

Aktorja Margarita Xhepa ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në fushën e artit me mbi 150 role në teatër e mbi 30 në kinematografi. Ajo do të ngelet e paharruar jo vetëm si një artiste e madhe, por edhe si një grua fisnike e me shumë vlera.

Një pjesë e rëndësishme e trashëgimisë artistike janë rolet e paharrueshme të kinematografisë, si te “Vitet e para”, “Dimri i fundit”, “Tokë e përgjakur”, “Një djalë edhe një vajzë”, “Apasionata”, “Gjeneral gramafoni”, “Rrethi i kujtesës”, “Gjurma”, “Vitet e pritjes”, “Dora e ngrohtë”, “Gurët e shtëpisë sime”, “Pranvera s’erdhi vetëm”, “Koncert në vitin 1936”, “E diela e fundit”, “I dashur armik” etj. Gjithashtu, po aq të paharrueshme janë edhe rolet e saj në teatër, si te “Hamleti”, “Mbreti Lir”, “Romeo e Zhuljeta”, “Rikardi III”, “Intrigë e dashuri”, “Moral i zonjës Dulka”, “Lumi i vdekur”,

“Kush e solli Doruntinën”, “Dhelpra dhe rrushtë”, “Xhaxha Vanja”, “Luiza Miler”, “Vizita e inspektorit”, “Vdekja e një komisioneri”, “Revizori”, “Qeni i kopshtarit”, “Elektra” etj, etj.

Si një ndër aktoret e para shqiptare, kjo aktore që mban titullin “Artiste e Popullit” dhe “Nder i Kombit” do të mbetet një prej gurëve të themelit të ngritjes së artit të aktrimit në Shqipëri dhe një pikë reference për artistët e rinj.

Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Tiranë, 3 prill 2025

www.akad.gov.al

Letër ngushëllimi
Kryesisë së Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës



I nderuar akad. Mehmet Kraja,

Të dashur kolegë,

Me dhimbje të thellë morëm lajmin për ndarjen nga jeta të akademik Salih Gashit, një prej figurave më të shquara të botës akademike dhe shkencore të Kosovës.

Akademik Gashi la pas një trashëgimi të pasur në fushën e kimisë fizike dhe kontribute të jashtëzakonshme në zhvillimin e arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor në Kosovë. Si studiues, profesor dhe udhëheqës shkencor, ai frymëzoi breza të tërë studentësh dhe kolegësh me përkushtimin, dijen dhe vizionin e tij.

Akademik Salih Gashi pati gjatë gjithë jetës së tij një bashkëpunim të ngushtë

dhe të frytshëm me kërkuesit edhe në Shqipëri, veçanërisht me profesorët e fushës së kimisë në Universitetin e Tiranës, që prej më shumë se pesë dekadash. Ai dha një kontribut të vyer në të gjitha aktivitetet e përbashkëta shkencore mes Seksionit të Shkencave të Natyrës të ASHAK-ut dhe Seksionit të Shkencave të Natyrës dhe Teknike të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Ndër angazhimet më të spikatura të viteve të fundit, përmendet roli i tij si kryesues i Këshillit Organizues të Konferencës së përbashkët shkencore ndërkombëtare me temë “Ndryshimet klimatike, resurset ujore dhe trajtimi i ujërave të ndotura”, mbajtur në maj 2024 në bashkëpunim me ASHAK dhe ASHSH. Po ashtu, akademik Gashi ishte pjesë e Këshillit Organizues të Edicionit të dytë të kësaj konference, që do të zhvillohet më 29–30 maj 2025 në Tiranë, me temë “Menaxhimi i integruar i ujërave për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit”.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i kontributit të tij në bashkëpunimin mbarëkombëtar ishte angazhimi në projektin e Enciklopedisë Shqiptare, ku ai kontribuoi si redaktor i redaksisë së fushës së Mjedisit për Kosovën. Gjatë këtij projekti, akademik Gashi pati një bashkëpunim të shkëlqyer me redaksinë homologe të Shqipërisë, duke u dalluar për mirëkuptim, profesionalizëm dhe përkushtim të veçantë, dhe duke ndihmuar në forcimin e frymës së bashkëpunimit akademik ndërmjet dy akademive.

Në këto momente të dhimbshme, Akademia e Shkencave e Shqipërisë shpreh ngushëllimet më të sinqerta për humbjen e një akademiku të shquar dhe një njeriu të urtë. Ju lutemi t’i përcillni ngushëllimet tona më të ndjera familjes së akad. Gashi, kolegëve të tij në Universitetin e Prishtinës, si dhe gjithë bashkëpunëtorëve dhe miqve që patën nderin ta njohin dhe të punojnë me të.

Me respekt të thellë,


Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

Tiranë, 21 prill 2025

<https://ashak.org/anetaret/salih-gashi/>

UNESCO dhe Shqipëria

“Muzeu Kombëtar i Fotografisë “Marubi” u shpall pjesë e regjistrit të kujtesës botërore UNESCO



Një nga thesaret më të çmuara të kujtesës sonë kombëtare “Muzeu Kombëtar i Fotografisë “Marubi” u bë pjesë e regjistrit të kujtesës së botës, UNESCO.

Ky muze aktualisht është i vetmi institucion kombëtar për fotografinë në Shqipëri. Arkivi i tij përmban më shumë se gjysmë milioni negativë filmash në xham, rrotulla dhe plan, si dhe objekte dhe dokumente të pesëmbëdhjetë fotografëve, si dhe fotografi me tematika të ndryshme që i përkasin kulturës shqiptare, urbanistikës, veshjeve kombëtare shqiptare, përfaqësive të huaja diplomatike, personaliteteve dhe zyrtarëve të lartë, ngjarjeve të ndryshme në vend.

Nominimi për përfshirjen në UNESCO është i lidhur me koleksionet e

fotografëve të parë të arkivit Marubi, pikërisht Pietro Marubbi (1832-1903), Mati Marubi (1862-1881) Kel Marubi (1869-1940).

Që nga viti 1865, kur u hap studioja e parë e fotografisë në Shkodrën otomane nga italianii Pietro Marubbi, deri në vitet 1940. Koleksioni i tyre dëshmon për lindjen e fotografisë në Shqipëri, pothuajse njëkohësisht me Europën. Arkivi i Muzeut Kombëtar “Marubi” është një dëshmi unike dhe e pazëvendësueshme e aspekteve historike, sociologjike, kulturore, antropologjike dhe artistike.

Lexo linkun:

<https://www.unesco.org/en/memory-world/register2025>

www.akad.gov.al